



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50 regjistër (JR)
Datë 01.09.2021

Nr. 45 i vendimit
Datë 01.10.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.10.2024, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 50/2021 (JR), datë 01.09.2021, që i përket:

- ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Genci Qana, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 362, datë 31.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Qana.
- BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet A, Ç, D, Dh dhe F të Aneksit të Kushtetutës; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e ngritura në ankim dhe në parashtrimet e datës 23.09.2024 të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndryshimin e vendimit

nr. 362, datë 31.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor përkatësisht deklaratën e pasurisë (në vijim “deklarata *vetting*”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet e mësipërm, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilave:
 - 3.1 ILDKPKI-ja¹, në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 3.2 DSIK-ja², me raportin nr. {***} prot., datë 30.10.2017, ka konstatuar *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Genci Qana.
 - 3.3 KLP-ja³ ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
 - 3.4 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim “ONM”), gjatë zhvillimit të hetimit në Komision, ka dërguar një mendim [nr. {***}, datë 23.03.2021], që lidhej me: (i) përfshirjen e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit përpara martesës nga “{***}” dhe “{***}”; (ii) pranimin e shpjegimeve të subjektit për blerjen e automjetit tip “Ford Fokus”; dhe (iii) pranimin e shpjegimeve të subjektit që një udhëtim i subjektit dhe personave të lidhur jashtë shtetit u pagua nga një individ tjetër. Sipas Vëzhguesit Ndërkombëtar:
 - (i) Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga puna duhet të përfshihen në mënyrë të plotë në analizën financiare nga Komisioni, pasi subjekti ka depozituar prova të mjaftueshme për të

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 26.09.2018.

² Dërguar me shkresën e DSIK-së nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 07.07.2020.

³ Raporti i KLP-së nr. {***} prot., 25.06.2020.

konkluduar që këto fonde kanë qenë të ligjshme. Për këto të ardhura, Vëzhguesi Ndërkombëtar i ka sjellë në vëmendje Komisionit aplikimin e parimit të proporcionalitetit dhe faktin që subjekti ka dorëzuar dokumente dhe indicie që provojnë se këto janë të ardhura nga paga/të ligjshme. Largimi i subjektit nga sistemi, në këto rrethana, nuk do të promovojë besimin e publikut në procesin e rivlerësimit, dhe as integritetin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

(ii) Në zbatim të parimeve dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit, sipas Vëzhguesit Ndërkombëtar, është e nevojshme të gjejë zbatim këndvështrimi proporcional. Sipas këtij këndvështrimi, edhe fakti se subjekti nuk ka deklaruar huan afatshkurtër të marrë nga z. E. V., dhe nëse blerja e automjetit “Ford Focus” do të merret në versionin më të papërshtatshëm për subjektin, do të rezultonte që ai do të gjendej në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimeve që shërbyen për blerjen para 9 vitesh. Pavarësisht se fillimisht subjekti nuk e qartësoi huan nga z. V., nuk ka diskutim se burimi i kësaj pjese të blerjes së makinës, ishte nga vlera që subjekti tërhoqi në fund të muajit dhjetor 2012.

(iii) Për më tepër, subjekti ka deklaruar edhe mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit njëjavor në Korfuz, Greqi, nga z. V., si mik i familjes. Në të njëjtën kohë, subjekti ka depozituar dokumentacion për të provuar se z. E. V. kishte të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e kësaj pagese, ndaj nuk ka ndonjë indikacion se subjekti kishte për qëllim fshehjen e kësaj dhurate.

(iv) Sipas Vëzhguesit Ndërkombëtar, një vlerësim në mënyrë të drejtë dhe proporcionale për subjektin do të kërkonte që mangësitë e subjektit të konsideroheshin *de minimus* në vlerësimin tërësor të pasurisë, pasi nuk konstatohen shkaqe nën parashikimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që në vlerësimin tërësor, të arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë apo ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Pasi ka kryer procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, me vendimin nr. 362, datë 31.03.2021, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit Genci Qana, bazuar në nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Në analizën e tij, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit:

(i) ka mungesë të burimeve financiare, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61, si dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;

(ii) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;

(iii) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të figurës, sipas pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; si dhe

(iv) në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka dështuar në kontrollin e pasurisë dhe figurës, ku rezultoi se ka bërë deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm.

5. Pas shpalljes së vendimit nga Komisioni, Vëzhguesi Ndërkombëtar në datën 09.06.2021 ka paraqitur një opinion kundër këtij vendimi, që në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon.

5.1. Në zbatim të parimit të proporcionalitetit, si parim themelor aspekteve të *vetting*, mangësitë e subjektit duhet të konsiderohen *de minimus*, në vlerësimin e analizës tërësore të pasurisë.

5.2. Në lidhje me çështjen e mbiemrit, ONM-ja vlerëson se ky ndryshim i padeklaruar nuk është përdorur për ndonjë avantazh, qëllim parregullsie apo korrupsioni. Veprimi i korigjimit është bërë dhe korigjuar nga punonjësi i gjendjes civile brenda pak muajve, që mbetet një fakt me rëndësi të papërfillshme për të shërbyer si shkak për shkarkim nga detyra. Ky ndryshim dhe mosdeklarim nuk nënkupton aplikimin e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, pasi duhet që të provohet se subjekti ka ndërmarrë veprime për deklarime të pasakta ose nuk ka deklaruar kontaktet me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Në çdo rast do të kryhet aplikimi i nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, për të konkluduar nëse gjendemi përpara kushteve të aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5.3. Nuk ka bazë, sipas pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që në vlerësimin tërësor, të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurive apo se në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, për të arritur në konkluzionin e shkarkimit nga detyra.

III. Shkaqet dhe pretendimet në ankim

6. Ndaj vendimit të mësipërm të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar nga Kolegji gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, paraqiten si më poshtë.

6.1. *Pretendimet me natyrë procedurale dhe për shkelje të procesit të rregullt ligjor*

(i) Sipas subjektit, është cenuar parimi i objektivitetit në gjykim, pasi është ndërprerë seanca dëgjimore e datës 09.03.2021, e cila u pasua me seancën e datës 12.03.2021, e cila konkludoi me vendim më datë 31.03.2021.

(ii) Është cenuar parimi i proporcionalitetit, pasi për t'u vendosur masa e shkarkimit nga detyra, duhet të plotësohen dhe të provohen në mënyrë të njëkohshme disa kriteret që kanë lidhje me vlerësimin pasuror, të integritetit dhe/ose të profesionalizmit. Sipas subjektit, që të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra, sipas pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duhet që shkeljet të jenë të një niveli me ato të parashikuara nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Përdorimi i fjalës “mund” në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, në: [...] “Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit”, përjashton automatikisht shkarkimin për pasaktësi në deklaratë, duke e analizuar në mënyrë diskrecionale sjelljen dhe rrethanat që lidhen me pasaktësinë, për të konkluduar nëse kemi përpara një veprimtarie të qëllimshme fshehje pasurie.

6.2. *Pretendimet në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

(i) Për apartamentin e banimit me sipërfaqe 80 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë në vitin 2001, subjekti ka ankimuar analizën e Komisionit. Kundërshtimet e tij lidhen me të ardhurat e bashkëshortes të përfituara para martesë dhe rilogaritjen e shpenzimeve të jetesës nga viti 1988-2000.

(ii) Për apartamentin me sipërfaqe 84,4 m², në Orikum, Vlorë, blerë në vitin 2011, subjekti nuk është dakord me konstatimin e Komisionit për mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 95.230 lekë për blerjen e këtij apartamenti dhe (-) 343.794 lekë për kryerjen e shpenzimeve të tjera në vitin 2011. Sipas subjektit, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë deklaratimet e tij se

një pjesë e gjendjes cash që disponohej në banesë është konvertuar në monedhën euro në momente të ndryshme, të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2011; në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI 2016 dhe në deklaratën e pasurisë vetting.

(a) Subjekti kundërshton Komisionin për rezultatin negativ në vlerën (-) 196.634 lekë (shuma e rezultateve negative për dy vitet 2009 dhe 2010), që ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes së të ardhurave nga paga e bashkëshortes nga shoqata “{***}”. Sipas tij, bashkëshortja ka qenë në mirëbesim për këtë fakt dhe nuk kishte dijeni rreth mbajtjes apo jo të tatimit mbi të ardhurat. Subjekti kërkon të kryhet rilogaritje e rezultatit financiar, duke përfshirë në analizë të ardhurat e bashkëshortes nga paga për periudhën 01.01.2009-31.12.2010.

(b) Në analizën financiare duhet të përfshihet paga e bashkëshortes e muajit dhjetor 2010, në vlerën 650 euro ose 90.285 lekë, që kaluan në llogari në muajin janar 2011. Argumenti i Komisionit se nuk është deklaruar si e ardhur në deklaratën periodike të vitit 2011 nuk qëndron, pasi është një e ardhur e ligjshme dhe mosdeklarimi ka ndodhur për shkak të harresës.

(c) Për pamjaftueshmërinë e deklarimeve në deklaratat periodike të viteve 2005 dhe 2007, subjekti nuk është dakord me konkluzionin e Komisionit për mospranimin e deklarimeve të cash-it në vitet 2005 dhe 2007, për shkak të korigjimeve të deklaratave. Sipas tij, korigjimet janë bërë përpara se deklaratat të dorëzoheshin. Nëse bëhet analizë për këto dy vite, lehtësisht konstatohet se gjendet në kushtet e mundësisë financiare për krijimin e gjendjeve cash.

(iii) Për *automjetin* [tip “Ford Focus”], subjekti nuk është dakord me konkluzionin e Komisionit se është gjendur në kushtet e mungesës së burimeve në shumën (-) 1.748.372 lekë për të justifikuar burimet e ligjshme, shtesën e likuiditeteve bankare dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 01.01.2012 – 11.12.2012.

(a) Subjekti pretendon se e ka deklaruar saktë burimin që ka shërbyer për blerjen e kësaj pasurie dhe e konsideron të padrejtë mospërfshirjen në analizë nga Komisioni të vlerës 730.000 lekë të tërhequr për kthimin e huas në fund të vitit 2012. Kjo vlerë duhet të përfshihet në analizën financiare. Për më tepër, Komisioni në mënyrë të gabuar e paraqet këtë shumë si shpenzim në analizën financiare për vitin 2012.

(b) Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk u provua që të ardhurat e huadhënësit, z. Z. D., të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2012, janë të ligjshme/tatueshme. Sipas tij, dokumentacioni i dorëzuar provon se huadhënësi kishte mundësi që të krijonte dhe jepte hua vlerën 5.000 euro, e cila duhet të përfshihet në analizën financiare, si një ndër burimet ligjshme të krijimit të pasurisë objekt analize. Komisioni ka tejkaluar kufijtë e hetimit të personave të tjerë të lidhur, elaboruar në jurisprudencën e Kolegjit.

(c) Shpenzimet e udhëtimit në Korfuz, Greqi, në vitin 2012, janë mbuluar nga miku i tij, z. E. V.. Ky fakt dhe marrëdhënia miqësore janë deklaruar në procesverbal në ILDKPKI-së në vitin 2016. Komisioni nuk mund edhe të hedhë dyshime se janë paguar nga subjekti e në të njëjtën kohë të konstatojë trajtimin preferencial. Për rrjedhojë, ai pretendon se vlera e shpenzimeve të udhëtimit 1.299 euro duhet të zbritet nga analiza financiare.

(v) Për *automjetin e bashkëshortes* [tip “Fiat Punto”], deklarimi i burimit të *ardhura nga kursimet* në deklaratën *vetting* është i saktë e në përputhje me ligjin. Burim i krijimit janë kursimet nga të ardhurat e gjithë vitit 2013, me të cilat i shleu huan vjehrrit që mori për qëllim blerjen e automjetit. Vlera 150.000 lekë i është dhënë në formë ndihme nga prindërit

bashkëshortes. Këtë vlerë ua ka kthyer brenda vitit, me të ardhurat nga kursimet dhe në deklaratën periodike nuk kishte asnjë rubrikë që të deklaronte marrëdhëniet që krijoheshin brenda vitit.

(vi) Për *mosdeklarimin e përdorimit* të apartamentit të vjehrrit në deklaratat periodike të viteve 2008-2011, subjekti pretendon se deklarimet e tij dhe të bashkëshortes kanë qenë në përputhje me ligjin e kohës. Sipas subjektit, mosdeklarimi i përdorimit të apartamentit për këtë periudhë ka ndodhur për faktin se deri në atë moment kjo pronë nuk ka qenë e regjistruar në hipotekë dhe, *de jure*, subjekti nuk ishte pronar i saj.

6.3. Konstatimi për *deklarim të pasaktë në formularin e figurës* është i gabuar. Ndryshimi i mbiemrit për një periudhë 8-mujore është bërë nga punonjësja e gjendjes civile. Nëse këtë kërkesë do ta kishte bërë ai vetë, ndryshe nga sa shprehet Komisioni, në vendim, nuk legjitimohej që të ndryshonte mbiemrin e gjithë familjes. Për këto arsye, subjekti kërkon që Kolegji të trajtojë deklarin e tij si të saktë e të mjaftueshëm në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016.

III/1. Parashtrimet e depozituara në Kolegji

7. Subjekti i rivlerësimit më datë 23.09.2024 ka paraqitur parashtrimet e tij si shtesë të ankimit të depozituar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Në argumentet e parashtruara, subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar shkaqeve dhe pretendimeve në ankimin e ushtruar prej tij mbi vendimin e Komisionit dhe ka argumentuar qëndrimin e tij mbështetur në vendime të marra nga Kolegji në periudhën e ndërmjetme, sikurse edhe arsyetimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, me fokus proporcionalitetin dhe faktin që një pjesë e të ardhurave, për të cilat është kryer vlerësimi i kriterit të pasurisë, janë krijuar nga bashkëshortja përpara martesë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Bazuar në nenin 179/b, pikat 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, me përjashtim të vendimeve për pezullim dhe detyrim për trajnim një vjeçar⁴. Çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin atë nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Qana, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

8.1. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar

⁴ Parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8.2. Në përputhje me nenin 65 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit nr. 362, datë 31.03.2021, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

9. Sa i përket kërkesës së subjektit në ankim, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues i Kolegjit, pasi vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, çmoi se nuk lind nevoja e pranimit të kësaj kërkesë, për sa kohë aktet që gjenden në dosje, në gjendjen që janë, janë të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes dhe kanë fuqinë të ndryshojnë rezultatin përfundimtar. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit për procesin e rregullt ligjor

(i) Për sa i përket pretendimeve se është cenuar parimi i objektivitetit në gjykim

10. Sa i përket pretendimit të subjektit se gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni është cenuar parimi i objektivitetit në gjykim, pasi është ndërprerë seanca dëgjimore e datës 09.03.2021, trupi gjykues i Kolegjit konstaton si vijon:

10.1. Subjekti i rivlerësimit, më datë 01.03.2021, i ka paraqitur Komisionit përgjigjet e rezultateve të hetimit. Në datën 05.03.2021, Komisioni ka njoftuar atë se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 09.03.2021, ora 10:00. Seanca dëgjimore është zhvilluar sipas njoftimit dhe subjekti ka marrë pjesë personalisht. Sipas procesverbalit të seancës, pjesë e fashikullit, Komisioni ka caktuar datën 12.03.2021, ora 10:00, për shpalljen e vendimit. Për këtë datë ka marrë dijeni edhe subjekti i rivlerësimit, i cili ishte prezent.

10.2. Me vendimin nr. {***}, datë 09.03.2021, Komisioni ka shtyrë shpalljen e vendimit për shkak se për subjektin është paraqitur një denoncim nga publiku. Në këtë vendim, Komisioni nuk ka caktuar një afat se kur do të zhvillohej seanca e radhës apo kur do të shpallej vendimi. Këto detaje specifikohen në vendim, sikurse edhe që seanca e caktuar në datën 12.03.2021, për shpalljen e vendimit, shtyhet për të verifikuar nëse denoncimi përmban shkaqe që mund të sugjerojnë riçeljen e hetimit administrativ. Vendimi urdhëron edhe njoftimin e subjektit për këtë fakt. Në fashikull nuk gjendet denoncimi e paraqitur në këtë datë [09.03.2021]. Në dosje është administruar një përgjigje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila referon kërkesën e Komisionit nr. {***} prot., datë 10.03.2021 -- pas seancës dëgjimore. Kërkesa e Komisionit në përgjigje të të cilës ka ardhur kjo shkresë, po ashtu *nuk* është pjesë e dosjes së përcjellë në Kolegji. Prokuroria i ka dërguar Komisionit praktikën e regjistrimit të një procedimi

penal të datës 04.03.2021, që i përket një prokurori tjetër. Ndër aktet në fashikullin Komisionit, dërguar në Kolegj, ndodhet edhe një e-mail i datës 29.03.2021, që njofton subjektin për datën dhe orën e shpalljes së vendimit [datë 31.03.2021] dhe konfirmimi i tij për pjesëmarrjen në këtë seancë.

10.3. Më tej, nga aktet konstatohet se më datë 31.03.2021, ora 09:45, është mbajtur procesverbali për shpalljen e vendimit. Nga procesverbali rezulton se kryesuesja ka përmbledhur vendimin e mësipërm të Komisionit, për arsyen për të cilën është shtyrë seanca e shpalljes së vendimit. Kryesuesja, po ashtu, ka konstatuar se nuk lindi nevoja për hetim të mëtejshëm dhe vendosi që në këtë datë të shpallë vendimin.

10.4. Në referim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 49/2012, i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në pikën 3 të nenit 88 të Kodit të Procedurave Administrative është përcaktuar se vendimi merret pas kalimit të afatit për ushtrimin e të drejtës për t'u dëgjuar. Në rastin konkret, vendimi është marrë pas dëgjimit të subjektit. Referuar dispozitave procedurale civile, të cilat thirren në zbatim në gjykimin administrativ, pasi merr fund hetimi gjyqësor, nuk mund të merren prova të reja, përveçse kur kërkohet nga palët⁵. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, dhe rëndësia që marrin denoncimet në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, një ndër arsyet që legjitimon përfshirjen/marrjen e provave të reja, edhe pas caktimit të seancës gjyqësore, është interesi publik. Duke mbajtur në konsideratë interesin publik, për të cilin zhvillohet procesi i rivlerësimit kalimtar, shtyrja e seancës së shpalljes së vendimit, për të vlerësuar nëse denoncimi i publikut përmbante elementë që mund të motivonin riçeljen e hetimit, është e legjitimuar, sipas germës “c” të pikës 1 të nenit 186 të Kodit të Procedurës Civile. Në vlerësim të trupit gjykues, shtyrja e seancës për rrethanat e mësipërme nuk përbën të metë/shkelje procedurale.

10.5. Për më tepër, në kushtet që përfundimisht Komisioni konstatoi se denoncimi nuk përmbante të dhëna apo indicie që kërkonin riçelje të hetimit administrativ, dhe referuar vendimit të Komisionit nuk është marrë në konsideratë në vlerësimin e subjektit, në vlerësimin e gjithë procedurës së ndjekur, trupi gjykues vëren se nuk është cenuar objektiviteti i gjyqimit, sikurse pretendon subjekti e as nuk ka përbërë shkelje procedurale. Shtyrja e seancës në vetvete nuk mund të argumentohet se ka sjellë pasoja për subjektin.

11. Subjekti pretendon se në mënyrë që të disponohet me masën *e shkarkimit* nga detyra, duhet të plotësohen dhe të provohen në mënyrë të njëkohshme disa kritere që kanë lidhje me vlerësimin pasuror, integritetin dhe/ose profesionalizmin.

11.1. Normat kushtetuese e ligjore, të cilat parashikojnë situatat që passjellin masën disiplinore të shkarkimit, përcaktuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, janë autonome. Në varësi të rrethanave konkrete, sikurse është trajtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), ndër të tjera, në çështjen *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë dhe në praktikën e Kolegjit, secila prej përcaktimeve të dispozitës në fjalë mund të passjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, parë në kuptim të deklaramentit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61 të po këtij ligji.

⁵ Neni 304 i Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 151 dhe 186 të këtij Kodi.

11.2. Neni 61 i ligjit nr. 84/2016, në gjashtë (6) situatat ligjore që përfshin, nënkupton që subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht dhe me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Në drejtim të rasteve për të cilat merret si masë disiplinore shkarkimi nga detyra, praktika e konsoliduar e Kolegjit ka konkluduar se nuk është e nevojshme që të plotësohen në mënyrë të njëkohshme disa kriteret, për t'u marrë masa e shkarkimit nga detyra, sikurse është edhe rasti konkret.

12. Në të njëjtën mënyrë analizohen edhe pretendimet lidhur me arsyen pse ligjbërësi ka përdorur fjalën “*mund*” në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 se: “*Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*”, nëpërmjet së cilës subjekti pretendon se përjashton automatikisht shkarkimin për pasaktësi në deklaratë, duke e analizuar në mënyrë diskrecionale sjelljen dhe rrethanat që lidhen me pasaktësinë, për të konkluduar nëse jemi përpara një veprimtarie të qëllimshme fshehje pasurie.

12.1. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra merret sipas rrethanave të faktit për secilin rast, pa e lidhur këtë me qëllimin e subjekteve për të fshehur pasurinë. Në legjislationin që rregullon procesin e rivlerësimit, nuk ka asnjë parashikim, i cili vendos si parakusht që qëllimi i fshehjes së pasurisë duhet të konstatohet si e vetmja pasojë e një konkluzioni të shkarkimit nga detyra, vetëm se në shtojcë është përfshirë si mundësi dhe jo detyrim. Shkaqet e shkarkimit nga detyra janë përcaktuar në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 33, pika 5 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të analizuar gjerësisht në praktikën e Kolegjit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit nuk qëndron.

13. Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe parashtrimet që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe atë të figurës, vlerësoi se vendimi objekt analize i Komisionit duhet të ndryshohet, pasi *nuk* është i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova. Arsyetimi i trupit gjyqësor të Kolegjit shtjellohet në vijim.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë

*C.I. Për apartamentin e banimit me sipërfaqe 80 m², në rrugën “{***}”, Tiranë*

14. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit objekt analize, në vitin 2001, kundrejt vlerës 2.000.000 lekë. Si burim të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta me bashkëshorten të krijuara nga kursimet ndër vite, që nga data 01.12.1988, nga paga si hetues dhe Oficer i Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”), si dhe nga data 01.02.2000, si prokuror. Në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti e ka deklaruar këtë apartament të blerë bashkë me bashkëshorten, me burim nga të ardhurat për çdo vit.

14.1. Komisioni ka konstatuar përfundimisht se subjekti i rivlerësimit ka një balancë negative në vlerën (-) 1.169.377 lekësh të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe një automjeti në vitin 1998, si dhe kryerjen e shpenzimeve minimale për këtë periudhë. Vlerësuar së bashku me faktin që apartamenti objekt analize është blerë me një çmim që përbën më pak se 50% të atij mesatar në tregun e lirë, Komisioni krijoi bindjen se subjekti gjendet në kushtet e

pamundësisë financiare për blerjen e kësaj pasurie, parashikuar nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

14.2. Subjekti ka ankimuar përfundimet e Komisionit, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes *para martese* dhe rillogaritjen e *shpenzimeve* të jetesës nga viti 1988-2000. Konkretisht, subjekti potencon se është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacionin e shlyerjes së detyrimit tatimor, parashikuar në pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti, po ashtu, ka kërkuar që analiza financiare për periudhën 1988 – 16.02.2001 të përfshijë gjithë të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi, duke rillogaritur shpenzimet e jetesës, sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji, përkundër përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në vlerën e 66% të të ardhurave nga Komisioni.

14.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, korrigjoi vendimin e Komisionit, për sa i përket mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën kohore përpara vitit 2000 – që përkon me një periudhë kohore për të cilën mungon metodologjia e INSTAT-it, në linjë me orientimin e Kolegjit që gjen pasqyrim në jurisprudencën e tij të mëparshme. Po ashtu, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni në funksion të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ka një sërë provash e indiciesh, të cilat mbështesin pretendimin e subjektit për ekzistencën e vazhdueshme të marrëdhënieve të punësimit të personit të lidhur/bashkëshortes me dy organizata joqeveritare në periudhën kohore nga fundi i vitit 1998 deri dhe duke përfshirë vitin 2001. Në vijim të këtij vlerësimi dhe duke pasur parasysh kohën e konsiderueshme që ka kaluar, faktin që një pjesë e të ardhurave – të krijuara përpara martese -- kanë lënë gjurmë dokumentare në një sërë aktesh, sikurse edhe faktin që përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore i përket personave juridikë/punëdhënës, ndërsa nga ana tjetër nuk rezultojnë e provuar dijenia apo veprime të kryera nga personi i lidhur që do të provonin ndërveprim aktiv prej saj në mënjanimin e detyrimeve financiare nga punëdhënësit, trupi gjykues vendosi të përfshijë në analizë të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën *vetting* nga punësimi i personit të lidhur/bashkëshortes, për të cilat ka gjurmë dokumentare të kohës, direkte apo rrethanore. Për rrjedhojë, ndonëse subjekti rezultoi në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e kryer në Kolegji balanca negative që rezultoi ishte më e ulët. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

14.4. Nga aktet në fashikull, rezultojnë se konkluzioni i Komisionit ka pasur për bazë analizën e kryer mbi të ardhurat e deklaruara nga punësimi i bashkëshortes së subjektit në tri shoqata jofitimprurëse e konkretisht: “{***}”, “{***}” dhe “{***}”. Subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në datën 06.09.2000. Pas shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, Komisioni ka konkluduar që:

(a) Për të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në *shoqatën* “{***}” -- [në varësinë e të cilës ishte qendra “{***}”] -- do të pranohen vetëm të ardhurat e periudhës janar – prill 1999. Për pjesën tjetër, dokumentacioni ka mospërputhje dhe nuk provon pagesën e detyrimeve tatimore⁶. Po ashtu, subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhurat e

⁶ Vendimi i Komisionit ka një lapsus në shkrim, pasi ka dy qëndrime të kundërta të shprehura me shkrim, për këto të ardhura. Në analizën financiare të subjektit, këto të ardhura në fakt, nuk janë përfshirë. Prezumohet se mungon fjala “nuk” përpara “duhet” në paragrafin 41 të vendimit. <https://aksedrejtisi.al/dokumenta/1711719427KPK-Vendim-Genci-Qana.pdf>.

përfituara nga kjo shoqatë për periudhën 1998-2001. Vërtetimi i dërguar nga subjekti se “{***}” ka qenë në varësi të shoqatës “{***}”, nga e cila janë mbajtur detyrimet tatimore për këtë periudhë, nuk justifikon mosdeklarimin e saktë në deklaratën *vetting* të emrit të punëdhënësit. Të ardhurat *neto* nga paga e bashkëshortes në 1998-2001 janë deklaruar pa dokumentacion mbështetës, në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

(b) Dokumentacioni për të ardhurat e bashkëshortes nga “{***}”⁷ nuk tregon përmbushjen e kriterit të ligjshmërisë⁸, pasi: (i) ato nuk janë deklaruar në deklaratën *vetting*; (ii) dokumentacioni nuk vërteton marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes me këtë shoqatë dhe nuk provon pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura; dhe (iii) në asnjë nga shkresat, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit, mungesa e dokumentacionit nuk i atribuohet kohës apo shkaqeve të tjera.

(c) Komisioni konkludoi se deklarimi i të ardhurave dhe i kontributeve për bashkëshorten nga “{***}”, bazuar në vërtetimin e Drejtorisë së Arkivit Qendror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”) që mban datën 30.07.2020, fillon nga tetori i vitit 2000. Të ardhurat nga kjo shoqatë përpara kësaj periudhe nuk u provuan me dokumentacion ligjor provues si të tatueshme, ndaj dhe ato nuk *duhet të përfshihen*⁹ në analizën financiare si të ardhura nga paga.

(d) Për sa më lart, nga të ardhura të bashkëshortes të dokumentuara, e për të cilat provohet shlyerja e kontributeve, për vitin 1999, Komisioni përfshiu në analizë vetëm vlerën 122.588 lekë, si e ardhur nga shoqata “{***}” dhe 77.220 lekë (tetor 2000-16.02.2001), nga shoqata “{***}”.

14.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të potencuara nga subjekti në ankim dhe në parashtrime, trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza e Komisionit dhe pretendimet e subjektit për pasurinë objekt analize shtrohen në tri drejtime: (i) në lidhje me provueshmërinë e ekzistencës së marrëdhënies së punës së personit të lidhur me subjektin; (ii) me të ardhurat e personit të lidhur të krijuara para martesë; dhe (iii) shlyerjen e detyrimeve tatimore nga marrëdhënia e punës.

14.6. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konkludoi se Komisioni ka gabuar në analizën për pranueshmërinë e provave dhe ngarkimin e subjektit me barrën e provës për të provuar të ardhurat e bashkëshortes të krijuara para martesë. Në këtë konstatim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe që përpos faktit se subjekti i ka deklaruar të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja para martesë në deklaratën *vetting*, për to janë paraqitur edhe një sërë indiciesh nëpërmjet të cilave nuk mund të argumentohet logjikshëm se nuk provohet ekzistenca e marrëdhënies së punës. *Së fundmi*, nga aktet në fashikull dhe shpjegimet e subjektit, si dhe kërkesat ligjore që normojnë marrëdhëniet e punësimit, Komisioni do të duhet të kishte marrë një qëndrim të ndryshëm për të ardhurat e gjeneruara nga punësimi i bashkëshortes dhe përmbushjen e kriterëve të ligjshmërisë, bazuar në shlyerjen e detyrimeve tatimore për to.

14.7. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga hetimi administrativ kanë rezultuar një sërë provash e indiciesh, të cilat mbështesin pretendimin e subjektit për ekzistencën e marrëdhënieve të vazhdueshme të punësimit të personit të lidhur/bashkëshortes me organizata

⁷ Referuar në vijim edhe si “{***}”.

⁸ *Ibid.*

⁹ *Si më sipër. Në paragrafin 45 Komisioni shprehet “duhet”. Presumohet se është një gabim për shkak të përdorimit të një teksti të mëparshëm.*

joqeveritare në periudhën kohore nga fundi i vitit 1998 deri në vitin 2000 e 2001. Nga ana tjetër, trupi gjykues vendosi të përfshijë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti për krijimin e pasurisë objekt analize të ardhurat e deklaruara në deklaratën *vetting* nga punësimi i personit të lidhur/bashkëshortes, për të cilat ka gjurmë dokumentare të kohës, direkte apo rrethanore, duke mbajtur parasysh: (i) kohën e konsiderueshme që ka kaluar; (ii) faktin që një pjesë e të ardhurave janë krijuara përpara martesë, kanë lënë gjurmë dokumentare në një sërë aktesh; sikurse edhe (iii) faktin që përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore i përket personave juridikë/punëdhënës; ndërsa nga ana tjetër (iv) nuk rezultojnë veprime të kryera nga personi i lidhur që do të provonin ndërveprim aktiv prej saj në mënjanimin e detyrimeve financiare nga punëdhënësit.

14.8. Në vijim të vlerësimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se të ardhurat nga punësimi i saj për këtë periudhë janë krijuar nga paga pranë Ministrisë së Shëndetësisë, nga punësimi nga tre shoqatat joqeveritare/jofitimprurëse të sipër-referuara dhe dhurata të dasmës. Në seksionin e të ardhurave/angazhimet, bashkëshortja e subjekti ka detajuar përshkrimin e të ardhurave dhe vlerat përkatëse¹⁰. Në këtë mënyrë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, jo vetëm ka deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhurat e përfituara nga punësimi në këtë periudhë, por edhe ka justifikuar me dokumentacion ligjor të kohës të ardhurat e deklaruara.

C.I.1. Për marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes me shoqatat joqeveritare

14.9. Komisioni ka administruar një sërë aktesh¹¹ në drejtim të *ekzistencës* së marrëdhënies së punës dhe nivelin e të ardhurave. Prej tyre, rezulton se bashkëshortja e subjektit kishte marrëdhënie pune me tre shoqatat e marra në analizë. Konkretisht, në ndryshim nga sa ka

¹⁰ Konkretisht, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: Paga nga puna në Ministrinë e Shëndetësisë, në muajt tetor – nëntor 1998 – 16.340 lekë; Paga nga punë si punonjëse sociale në {***}, nga 01.11.1998 – 31.12.2000 – 800.000 lekë; Paga nga puna si punonjëse sociale në {***}, nga 01.01.2001 – 31.12.2001 – 300.000 lekë. Paga si punonjëse sociale në shoqatën {***} nga 01.04.1999 – 31.12.2000 – 360.060 lekë; Paga si punonjëse në {***}, nga 01.01.2001 – 31.12.2008 – 1.611.000 lekë.

¹¹ Për të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, gjatë hetimit në Komision janë administruar në cilësinë e provës këto akte: (i) Letër reference [në gjuhën angleze], e datës 27.1.2001, nënshkruar nga koordinatori e projektit të qendrës "{***}". Nga përmbajtja e saj evidentohet se bashkëshortja e subjektit ka punuar në shoqatën {***} – {***} nga prilli i vitit 1999, me gratë e dhunuara dhe familjet e tyre; (ii) Vërtetim i datës 2.9.2003, nënshkruar nga koordinatori e projektit të qendrës "{***}", nga përmbajtja e të cilit evidentohet se bashkëshortja e subjektit është punonjëse sociale me kohë të plotë pranë kësaj qendre, që nga muaji prill i vitit 1999 e në vazhdim; (iii) Letër reference e datës 3.1.2011, nënshkruar nga drejtoresha ekzekutive e qendrës "{***}". Nga përmbajtja evidentohet se bashkëshortja e subjektit, ka punuar si punonjëse sociale pranë kësaj qendre në periudhën prill 1999 deri në 31.12.2010; (iv) Fotokopje e fletëve të librezës së sigurimeve të N. Q. mbi pagesat e kontributeve për periudhën janar 2002 – dhjetor 2010 me vulën e "{***}"; (v) Fotokopje e fletëve të librezës së punës së bashkëshortes së subjektit, çelur në 19.4.1999 nga {***}. Nga përmbajtja evidentohet se bashkëshortja e subjektit është e emëruar si punonjëse sociale nga data 19 prill 1999. Largimi nga puna është i datës 31 dhjetor 2010, i vulosur nga "{***}". Në fletët me nr. 8 dhe 9 paraqitet profesioni dhe paga prej 17.160 lekë; (vi) Në një vërtetim datë 25.02.2021 i shoqatës "{***}", është shënuar se kjo shoqatë, nga viti 1998 – 2006 ka qenë në varësi të shoqatës {***}, nga e cila janë mbajtur detyrimet tatimore; (vii) Përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 27.10.2020, për të dhënat e tatimpaguesit {***}; (viii) Vërtetimi i datës 2.7.2008, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim "ISSH") në të cilin evidentohet se bashkëshortja e subjektit, është e siguruar pranë subjektit "{***}" në periudhën tetor 2000 – dhjetor 2005; (ix) Vërtetim i ISSH-së, datë 17.01.2016, "Mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare", për të ardhurat e realizuara nga muajin nëntor – dhjetor 1998, mbi të cilat është derdhur kontribut nga Ministria e Shëndetësisë. Paga bruto është shënuar 6.040 lekë për muajin nëntor, dhe 10.300 lekë për muajin dhjetor; (x) Shkresa e ISSH-Drejtoria e Arkivit Qendror, e datës 30.07.2020, në të cilën jepet informacion mbi pagat mujore të përfituara nga bashkëshortja e subjektit, gjatë periudhës Tetor 2000 – Dhjetor 2005, nga shoqata {***}, mbi të cilat janë llogaritur kontributet e sigurimeve shoqërore. Sipas kësaj shkrese, paga e bashkëshortes së subjektit nga muaji tetor 2000 – dhjetor 2001 ishte 17.160 lekë (ashtu sikurse ishte evidentuar në librezën e punës).

vlerësuar Komisioni, evidentohet marrëdhënia e punësimit/të bashkëshortes, sikurse shtjellohet në vijim:

14.9.a. Me shoqatën “{***}” dhe “{***}” [si subsidiare e saj]: (i) kontrata e punës lidhur me shoqatën “{***}”; (ii) një vërtetim i datës 25.02.2021 i shoqatës “{***}”, në të cilin është shënuar se kjo shoqatë, nga viti 1998 – 2006 ka qenë në varësi të shoqatës “{***}” dhe nga kjo e fundit janë mbajtur detyrimet tatimore; (iii) një akt që mban edhe vulën e “{***}” edhe vulën e shoqatës “{***}”, me titull “Lista e pagave”, për muajt janar deri në prill të vitit 1999, ku evidentohet se bashkëshortja e subjektit është paguar nga shoqata “{***}” në vlerën 35.000 lekë në muaj; (iv) librezja e punës nga shoqata “{***}”; (v) skedat/ditaret e përditshmërisë së punës mbajtur nga bashkëshortja e subjektit në “{***}”; (vi) një mandat nga Banka e Kursimeve për pagimin e sigurimeve nga shoqata “{***}”, me numër serial {***}, datë 10.09.1999, së bashku me listën e punonjësve, ndër ta edhe bashkëshortja e subjektit.

14.9.b. Me shoqatën “{***}”, për periudhën e punësimit tetor-nëntor 1998¹², në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti dërgoi një vërtetim me datë 29.07.2020 nga shoqata “{***}”, ku shpjegohet se bashkëshortja e tij ka qenë punonjëse sociale pranë kësaj shoqate dhe është paguar nga nëntori 1998 - prill 1999 me pagë mujore 50.000 lekë. Nga maji i vitit 1999 – dhjetor të vitit 2001 me pagë mujore 25.000 lekë. Po në këtë pyetësor, subjekti ka dërguar edhe një vërtetim të përkthyer e noterizuar të organizimit të një kursi formimi në qendrën kundër dhunës nga shoqatat “{***}” dhe “{***}”, në të cilin bashkëshortja e subjektit ka marrë pjesë nga data 10.11.1998 – 29.11.1998. Subjekti, në ankim, ka ngritur pretendim se vërtetimi i shoqatave “{***}” dhe “{***}” tregon marrëdhënien e punës së bashkëshortes, si dhe ka listuar edhe dokumentet, ndër to, edhe “listë pagash” nga shoqata “{***}”, për periudhën 01.08.1999 – 31.10.1999 dhe nga janar 2000 - 30.04.2000, që bashkëshortja ka nënshkruar (borderonë) me 200.000 lireta për secilin muaj.

14.9.c. Me shoqatën “{***}”, për periudhën kohore nga 01.04.1999 - tetor 2000, lidhur me marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së subjektit përpara muajit tetor të vitit 2000, ku subjekti ka sjellë tre dokumente të kohës, të lëshuar nga “{***}”. Subjekti pretendon se këto akte provojnë, tej çdo dyshimi, se marrëdhënia e punës me shoqatën “{***}” ka filluar që në prill të vitit 1999. Për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së punësimit dhe shlyerjen e kontributeve nga data 19.04.1999, subjekti ka depozituar edhe disa akte të tjera, që i përkasin një periudhe kohore prej vitit 2001 e deri në vitin 2011, që konfirmojnë faktin e pretenduar. Në librezën e punës është shënuar se paga e bashkëshortes së subjektit është 17.160 lekë, ndërsa nga aktet e administruara nuk provohet pagesa e sigurimeve shoqërore përpara muajit tetor të vitit 2000. Vërtetimet e lëshuara në momente të ndryshme të kohës, konfirmojnë nisjen e marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së subjektit me këtë shoqatë që në prill 1999.

14.10. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet në fashikujt e Komisionit provojnë se ndonëse kontrata e punës së bashkëshortes së subjektit është lidhur me shoqatën “{***}”, vendin e punës e kishte në shoqatën “{***}”, si dhe ka ushtruar aktivitetet/veprimtari edhe në shoqatën “{***}”. Po ashtu, të ardhurat që bashkëshortja përfitoi nga shoqata “{***}”, duket se janë rrjedhë e bashkëpunimit të shoqatës “{***}” me këtë të fundit, siç evidentohet nga *Certifikata* e kursit që ndoqi bashkëshortja e subjektit, të organizuar nga këto dy shoqata së bashku në tetor të vitit

¹² Duket më tepër si lapsus, pasi sipas vërtetimit të ISSH bashkëshortes së subjektit i janë mbajtur kontribute për muajin nëntor dhjetor 1998, aq sa vlera e deklaruar prej saj.

1998. Nga një verifikim i burimeve të hapura, *online*¹³, rezulton që shoqata “{***}”, në Itali, është një simotër e shoqatës “{***}”, në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, “{***}”, duket se është projekt i shoqatës “{***}”¹⁴.

14.11. Në këto kushte, pas analizës së kryer në Kolegj, mbi bazën e vlerave financiare që rezultojnë nga aktet, rezultoi se vlerat e plotësuara nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën *vetting* përkojnë me vlerat e shënuara nga vërtetimet e lëshuara gjatë periudhës kur subjekti i ishte nënshtruar hetimit administrativ. Duke qenë akte të hartuara në kuadër të procesit të rivlerësimit, vlera e tyre provuese kufizohet. Në çdo rast, aktet e administruara në Komision shërbejnë për krijimin e bindjes së ekzistencës së marrëdhënies së punës së bashkëshortes së subjektit me këto shoqata, ndër to edhe me shoqatën “{***}”, që nuk u pranua si e provuar nga Komisioni.

14.12. Po ashtu, ekzistojnë disa mospërputhje të vlerës së pagës midis dokumentacionit të administruar në Komision dhe atij të dërguar nga subjekti. Ndër to, mund të përmendim: (i) në vërtetimin e mësipërm, lëshuar nga shoqata “{***}”, është shënuar që paga e bashkëshortes së subjekti ishte 250.000 lireta, ndërkohë që në kontratën e amenduar ishte 200.000 lireta; po ashtu (ii) ndryshe nga sa është evidentuar në këtë vërtetim që bashkëshortja mori 50.000 lekë/muaj, nga borderoja/lista e pagës duket se ka marrë 35.000 lekë/muaj dhe jo aq sa është shënuar në vërtetim.

14.13. Sipas dokumentacionit të përkthyer e të noterizuar nga gjuha italiane, bashkëshortja e subjektit ka nënshkruar “*in fede/në mirëbesim*” edhe disa “Deklarata për kryerjen e pagesës”, të cilat janë fotokopje me vulën e njomë të “{***}”. Nëpërmjet tyre deklarohet se bashkëshortja e subjektit ka marrë shumën prej 240.000 liritash, nga koordinatorja E. H. për kryerjen e veprimtarisë së operatorit në *Shtëpinë Pritëse*. Deklaratat nisin nga muaji dhjetor i vitit 2000 dhe vijnë deri në mars të vitit 2001.

14.14. Në Komision janë administruar edhe disa akte “skeda pranimi/bashkëbisedimi” në formën e fotokopjes, me kokën “{***}”, të vulosura me vulën e njomë të kësaj shoqate, të datës 09.06.1999 dhe 20.05.2000, së bashku me disa shënime/ditarë të punës së përditshme, të datave 25.01.1999; 26.01.1999 dhe një tjetër e vitit 1999 (që nuk i dallohet data), si dhe një faturë e datës 28.08.1999 lëshuar nga {***}, titulluar “{***}”, që përshkruan mallra ushqimore të ndryshme, e nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit. Komisioni ka administruar në dosjen hetimore edhe vërtetimin e datës 25.02.2021, lëshuar nga Drejtorja Ekzekutive e “{***}”, në të cilin është shënuar që personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja, nga nëntori 1998 – dhjetor 2001 ka qenë e punësuar si punonjëse sociale në këtë shoqatë.

C.I.2 Për ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortes

14.15. Në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, analiza e kryer nga Komisioni, për sa i përket përmbushjes së kritereve të ligjshmërisë për burimet e deklaruar të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit/personit të lidhur nga punësimet e marra në analizë, nuk është tërësisht e bazuar. *Së pari*, në zbatim nenit 10¹⁵ të ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, punëdhënësi ishte përgjegjës për mbajtjen e tatimit

¹³ https://***.it/chi-siamo/

¹⁴ https://www.***.org/albanian/{***}.html

¹⁵ “[1.] Çdo punëdhënësi, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germën “a”, të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.”

për të ardhurat nga paga. Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, evidenton se shoqata “{***}” është regjistruar si subjekt tatimor në korrik të vitit 2000. Në këto kushte, në mungesë të regjistrimit të kësaj shoqate si subjekt tatimor për periudhën kritike për analizën konkrete, nga viti 1999 – korrik 2000, nuk mund të argumentohet as shlyerja e detyrimeve tatimore prej këtij punëdhënësi. Nga vërtetimi i ISSh-së, për bashkëshorten e subjektit, janë paguar kontributet nga “{***}” nga muaji tetor i vitit 2000. Në këto kushte, në analizën e mundësisë së subjektit të rivlerësimit, u përfshinë të ardhurat nga kjo periudhë e në vijim.

14.16. Pretendimi i subjektit, në ankim, sipas së cilit detyrimet për kontributin nga paga, *duhet të jenë mbajtur* dhe paga (më së paku për shoqatën “{***}”) ka kaluar nëpërmjet bankës, duket se potencon qenien e bashkëshortes në mirëbesim, për sa i përket shlyerjes nga punëdhënësi të detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit. Ky argumentim duket se mbështetet edhe në faktin që nga lista e pagave për muajt janar-prill 1999 referohet paga në lekë 35.000, si dhe kontributet në vlerat respektive. Së bashku me këtë listë pagash administrohet edhe mandatarkëtimi i vulosur nga Posta Tiranë për Sigurime Shoqërore – kontribute, me numrin serial përkatës, me emrin e bashkëshortes së subjektit, në urdhër të personit që urdhëron kryerjen e veprimit, mban datat dhe vlerat e derdhura, sikurse edhe edhe përshkrimin “*sig. shoqërore*”.

14.17. Në kontratën e punës së datës 01.04.1999, lidhur nga bashkëshortja e subjektit me shoqatën “{***}”, si dhe në aktin me të cilin ajo është amenduar kontrata, është specifikuar që bashkëshortja e subjektit do të punojë si punonjëse në “{***}” dhe është përcaktuar paga përkatëse¹⁶. Po ashtu parashikohet se kjo kontratë lidhet me afat 9-mujor dhe paga jepet në datën 5 të çdo muaji. Në kontratë nuk është përcaktuar përgjegjësia e shlyerjes së detyrimeve tatimore. Për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave/shlyerjes e kontributeve, subjekti ka dërguar mandatin e datës 14.09.1999, nga Banka e Kursimeve, për tatime mbi pagën e të punësuarve në shoqatën “{***}”, për periudhën janar – qershor 1999. Ky mandat mban numër serial, emrin e Bankës së Kursimeve, emrin e urdhëruesit, datën, përshkrimin, numrin e llogarisë, vulën e përgjegjësimit të sportelit. Bashkëlidhur këtij mandati, është “Lista e Punonjësve”, nga shoqata “{***}”, ndër to, edhe bashkëshortja e subjektit. Me këtë dokument, gjendet edhe mandatarkëtimi i vulosur nga Posta Tiranë për Sigurime Shoqërore me numrin serial përkatës, me emrin në urdhër të personit që urdhëron kryerjen e veprimit, mban datat dhe vlerat e derdhura, po ashtu, edhe përshkrimin “*sig. shoqërore*”.

14.18. Në kushtet që në kontratën e lidhur me shoqatën “{***}” nuk parashikohet në mënyrë të shprehur përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se do të duhet të thirret në zbatim prezumimi ligjor, që në këtë rast i përket punëdhënësit. Duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimin ligjor të legjislacionit që rregullon sigurimet shoqërore¹⁷, për të ardhurat e krijuara nga muaji nëntor 1998 e vijim, mbajtja e detyrimeve të të punësuarve ishte parashikuar si detyrim i punëdhënësit. Ky parashikim ligjor, lexuar së bashku me legjislacionin në fuqi në kohën në fjalë për tatimin mbi të ardhurat [neni 10, referuar më sipër dhe cituar në poshtëshënim], qartazi përcakton si detyrim të punëdhënësit mbajtjen dhe derdhjen e tatimit mbi të ardhurat personale në favor të organeve tatimore.

14.19. *Së fundmi*, edhe aktet paraqesin indicie në formën e mandatpagesave në postë apo ato të derdhjes në bankë të pagesave të sigurimeve në periudha të ndryshme gjatë vitit 1999. Duke

¹⁶ Fillimisht paga 500.000 lireta në muaj, e amenduar në prill 1999 në vlerën 200.000 lireta në muaj.

¹⁷ Sipas pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet që: “Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t’i derdhë ato në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. [...]”.

mbajtur, gjithashtu, në konsideratë edhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoresha Ekzekutive e qendrës “{***}”, që mban datën 25.02.2021, sipas së cilit detyrimet tatimore janë paguar rregullisht nga shoqata “{***}”, përpos prezumimit ligjor të sipër-referuar, edhe në mënyrë të shprehur në kohën e tërheqjes së pagave, bashkëshortja e subjektit nuk mund të argumentohet se nuk ishte në mirëbesim se detyrimet ndaj buxhetit të shtetit përmbusheshin nga dy shoqatat punëdhënëse.

14.20. Një ndër aktet e administruara në Komision është edhe fotokopja e noterizuar e librezës së punës së bashkëshortes së subjektit, që si qendër pune tregon “{***}”. Aty referohet se paga ka qenë 17.160 lekë dhe profesioni si “Punonjëse sociale”. Sipas librezës duket se kjo marrëdhënie ka nisur nga data 19.04.1999 dhe ka zgjatur deri më 31.12.2010. Drejtorja e Përgjithshme të Tatimeve¹⁸ ka informuar Komisionin se tatimpaguesi “{***}” është regjistruar pranë këtij institucioni nga data 18.07.2000. Këto akte, tregojnë qoftë ekzistencën e marrëdhënies së punësimit, ashtu edhe qenien e bashkëshortes në mirëbesim e sidomos pritshmëri që detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore dhe ndaj buxhetit të shtetit ishin përmbushur ose do të përmbusheshin sipas ligjit.

14.21. Në një vështrim më të gjerë të situatës së marrëdhënies së punësimit, mënyra sesi funksionon sektori i organizatave joqeveritare, sikurse rezulton nga tërësia e akteve të administruara në hetimin administrativ, paraqet një panoramë në të cilën ato [shoqatat] kanë funksionuar deri diku të lidhura e ndërthurura në aktivitete me njëra-tjetrën, dhe disa prej tyre edhe të njëjtat mbështetje financiare, për shkak edhe të të njëjtit objekt veprimtarie, që përkon me nevojën për shërbime nga profili profesional i bashkëshortes së subjektit. Ky konstatim bazohet në faktin që ndërsa njëra shoqatë kishte tagrat/ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me bashkëshorten e subjektit, vendi i punës/ofrimi i konsulencës caktohej pranë shoqatës. Po ashtu, aktet e sjella tregojnë se të ardhurat janë përfituar herë nga njëra shoqatë herë e herë nga tjetra. Pavarësisht se librezën e punës e çeli që në prill të vitit 1999, nga ky moment deri në 25.04.2001 [momenti i fundit kur u pagua nga shoqata “{***}”], sipas dokumentacionit të ardhurat duket se bashkëshortja i mori nga shoqata “{***}”. Edhe në këtë rast, nga prilli 1999-16.02.2001, bashkëshortja e subjektit duket se kishte një marrëdhënie me shoqatën “{***}” dhe në të njëjtën kohë, nga 01.04.1999 – tetor 2000, përfitoi të ardhura edhe nga shoqata “{***}”. Së fundmi, në cilindo këndvështrim, librezja e punës mbetet një element i pakundërshtueshëm i provës së ekzistencës së marrëdhënies së punës më së paku, lidhur me momentin e çeljes së saj/fillimin e marrëdhënies së punës.

14.22. Përpos sa më sipër, një pjesë e këtyre të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting*, ato të fituara përpara shtatorit 2000, datojnë përpara lidhjes së martesës së subjektit me bashkëshorten. Për të gjitha këto aspekte të sipëranalizuara në detaj, përpos faktit që subjekti ka dokumentuar dhe justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara para martesë të personit të lidhur me të, trupi gjykues i Kolegjit vëren se mospërfshirja e tyre në mesin e burimeve të ligjshme nga Komisioni është veprim i pabazuar dhe efekti i tyre në analizë disproporcional me rrethanat ligjore e faktike që vërtetohen, me fokus faktin që koha e përfitimit të një pjese të tyre me rëndësi në analizë daton përpara martesë.

14.23. Trupi gjykues i Kolegjit, po ashtu, e gjeti të drejtë kërkesën e subjektit për të korrigjuar vendimin e Komisionit, edhe për mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën kohore përpara vitit 2000, për shkak të nivelit të të ardhurave të dokumentuara të

¹⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.2020, “Kthim përgjigje”.

bashkëshortes që janë konsiderueshëm më të larta sesa mesatarja dhe që subjekti ka qenë hetues e prokuror, në linjë me orientimin e Kolegjit, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e tij të mëparshme, për vitet kur nuk ka referenca të INSTAT-it për shpenzimet minimale jetike. Si rrjedhojë e këtyre qëndrimeve dhe korrektiveve, ndonëse subjekti rezultoi në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e kryer në Kolegj, balanca negative që rezultoi, në funksion të krijimit të pasurisë objekt analize dhe shpenzimeve të tjera, ishte në vlerën (-) 289.332 lekë, konsiderueshëm më e ulët se ajo e referuar në vendimin e Komisionit.

C.II.Apartamenti me sipërfaqe 84,4 m², në Orikum, Vlorë, blerë në vitin 2011

15. Subjekti dhe personi i lidhur kanë blerë apartamentin objekt analize, me vlerë 28.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes, datë 01.10.2011¹⁹, nga një person juridik. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi se si burim i krijimit të pasurisë shërbyen kursimet e krijuara nga të ardhurat deri në atë kohë, të ruajtura në euro duke u konvertuar në mënyrë sistematike çdo vit, sipas kursit të kohës. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat e krijuara nga kursimet në lekë (të kthyer në euro) në vitet e mëparshme dhe kursimet e vitit 2011. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 16.02.2016, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer kursimet nga paga të deklaruara në deklaratat e interesave private ndër vite, të cilat janë konvertuar vit pas viti në mënyrë sistematike në euro, sipas kursit të këmbimit të kohës, ndërsa pjesa tjetër për plotësimin e shumës ka qenë mbuluar nga të ardhurat e vitit 2011.

15.1. Komisioni konstatoi se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u bazua në mënyrën sesi Komisioni vlerësoi deklaratimet e subjektit për gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar. Konkretisht, Komisioni shprehet se subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar kryerjen e këmbimit të shumës *cash* të përdorur nga lekë në monedhë euro në vite të ndryshme, ndryshe nga deklarimi i ndryshimeve/gjendjeve të llogarive bankare në euro, të cilat i ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse. Po ashtu, sipas analizës së Komisionit, subjekti ka pasur mungesë burimesh për blerjen e kësaj pasurie në masën (-) 95.230 lekë dhe një bilanc negativ të vitit 2011 prej (-) 343.794 lekësh. Komisioni nuk përfshiu në mesin e të ardhurave të ligjshme ato të cilat deklarohen nga punësimi i bashkëshortes së subjektit nga shoqata “{***}” për vitet 2009-2010, për shkak të mungesës së dokumentimit të marrëdhënies së punës dhe ligjshmërisë së të ardhurave. Po ashtu, Komisioni nuk përfshiu në analizë kursimet e deklaruara në deklaratat periodike të viteve 2005 dhe 2007, për shkak se nuk i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit rreth korrigjimeve të deklaratave.

15.2. Subjekti nuk është dakord me konstatimin e Komisionit dhe kundërshton, duke potencuar se:

(i) Nëse do të merren në konsideratë shpjegimet e tij se një pjesë e gjendjes *cash* që disponohej në banesë është konvertuar në monedhën euro në momente të ndryshme, sikurse deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016 dhe

¹⁹ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

në deklaratën e pasurisë *vetting*, ai rezulton me mundësi për blerjen e këtij apartamenti dhe përballimin e shpenzimeve të tjera të vitit 2011.

(ii) Subjekti kundërshton mospërfshirjen në analizën financiare nga Komisioni të vlerës prej 196.634 lekësh, si të ardhura nga paga e bashkëshortes në shoqatën “{***}”. Subjekti pretendon se në kushtet e kalimit të pagës nëpërmjet rrugës bankare, bashkëshortja ka qenë në mirëbesim dhe nuk kishte dijeni rreth shlyerjes së tatimit mbi të ardhurat nga punëdhënësi dhe kërkon të kryhet rishikimi i analizës financiare për periudhën në fjalë, duke përfshirë treguesit e të ardhurave të bashkëshortes nga paga për periudhën 01.01.2009-31.12.2010.

(iii) Në analizën financiare të vitit 2011 duhet të përfshihet paga e bashkëshortes për muajin dhjetor 2010, e cila ka kaluar në llogari në muajin janar 2011 në vlerën 650 euro [ose 90.285 lekë]. Argumenti i Komisionit se kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare për shkak se nuk është deklaruar si e ardhur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, në vlerësim të subjektit, nuk qëndron, pasi kjo është një e ardhur e ligjshme e vërtetueshme nga dokumentacioni bankar dhe mosdeklarimi i saj ka ndodhur për shkak të harresës.

15.3. Trupi gjykues e vlerësoi të gabuar qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë të ardhurat nga paga e bashkëshortes/personit të lidhur në shoqatën “{***}” për periudhën 01.01.2009-31.12.2010, sikurse edhe mospërfshirjen e një page të vitit 2010, për të cilën ka konfirmim bankar. Nga ana tjetër, trupi gjykues nuk i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit se *një pjesë* e gjendjes *cash* që disponohej në banesë ishte konvertuar në monedhën euro në momente të ndryshme. Nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur u gjendën në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në një vlerë të papërfillshme për të mbuluar financimin e apartamentit [(-) 53.910 lekë] e, për rrjedhojë, të panevojshme për ta përlllogaritur nën dritën e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

*C.II.1. Për të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në shoqatën “{***}” në vitet 2009-2010*

15.4. Pasi ka administruar shkresa nga institucione të ndryshme lidhur me punësimin e bashkëshortes së subjektit, Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e bashkëshortes sipas një shkrese të Drejtorisë së Arkivit Qendror²⁰, duke reduktuar pjesën takuese të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punëmarrësit dhe tatimin mbi të ardhurat²¹. Në vijim të kësaj analize, vitet 2009 e 2010 kanë rezultuar me balanca negative përkatësisht në vlerat (-) 100.700 lekë dhe (-) 95.934 lekë. Nga aktet bankare, rezulton se bashkëshortja e subjektit është kredituar me përshkrimin “pagë” në vlerë të konsiderueshme më të lartë sesa ajo që ka përlllogaritur Komisioni, e konkretisht: 1.570.375 lekë për periudhën 2009-janar 2010, kundrejt vlerës së reduktuar e përlllogaritur sipas qëndrimit të mësipërm, në 1.046.341 lekë. Nga shkresa e Drejtorisë së Arkivit Qendror referohen të ardhurat për pagën bazë mbi të cilën përlllogariten kontributet e sigurimeve, që në total referohen në vlerën 1.325.300 lekë. Komisioni ka konkluduar se nuk mbështetet pretendimi i subjektit se kanë qenë shpërblime apo bonuse, të cilat nuk përjashtohen nga detyrimi i tatimit mbi të ardhurat. Po ashtu, sipas Komisionit, subjekti nuk dokumentoi marrëdhënien kontraktuale, kushtet e punës/pagesës së bashkëshortes, për vitet

²⁰ Nr. {***} prot., datë 18.10.2016 – dërguar nga subjekti në ILDKPKI.

²¹ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.2020, është përgjigjur se e nuk ka informacion për punonjës në veçanti, “{***}” është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore më 18.7.2000, por në sistem nuk ka listëpagesa të asnjë subjekti tatimpagues për periudhën përpara 01.01.2012. ISSh-ja konfirmon se mbi pagën e bashkëshortes së subjektit janë derdhur kontribute nga viti 2000 – 31.12.2010 nga shoqata “{***}”.

2009 – 2010, si dhe nuk depozitoi dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave, për sa nuk u provua pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore për to. Komisioni nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit në janar 2011, që përkon me blerjen e pasurisë, pasi konstaton se këtë vit nuk janë deklaruar të ardhura.

15.5. Nga aktet e administruara në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se marrëdhënia e punë së bashkëshortes së subjektit me personin juridik në fjalë provohet përtej çdo kontestimi. Konkretisht, shkresat nga Arkivi i ISSh-së dhe aktet bankare, sikurse edhe shkresat e administratës tatimore, konfirmojnë jo vetëm marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së subjektit, por edhe faktin që shoqata “{***}” është regjistruar si person juridik nën dritën e legjislacionit shqiptar²², që nënkupton edhe marrjen përsipër të detyrimeve ligjore në mënyrë të shprehur. Nga ana tjetër, konfirmimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve se nuk disponon të dhëna për punonjësit e punësuar para vitit 2012, nga asnjë subjekt tatimpagues, është alogjik të peshojë kundër pretendimit të subjektit për ekzistencën e marrëdhënies së punësimit, e sidomos është alogjike që prej saj të deduktohet se janë pa vlerë provuese e pa peshë të dhënat që rezultojnë nga shkresat e tjera, përfshirë aktet zyrtare nga institucionet e tjera apo deklaratimet e të ardhurave ndër vite e shkresat bankare.

15.6. Edhe në një vlerësim të frymës së ligjit për marrëdhënien e punës dhe në mungesë të kontratës, fakt të cilit Komisioni duket t’i ketë dhënë rëndësi primare, kur punëmarrësi pranon të kryejë një punë sipas urdhrave të punëdhënësit kundrejt pagesës, kontrata e punës konsiderohet e lidhur²³, ndërsa shkelja e dispozitave që lidhen me elementë të formës së kontratës²⁴ passjell penalitete financiare për *punëdhënësin*. Në kushtet që ekzistenca e marrëdhënies së punës provohet edhe me dokumente të tjerë -- në rastin konkret nga librezat e punës, vërtetimi i sigurimeve shoqërore për kontributin mbi pagën, kalimin e pagës nga punëdhënësi në llogarinë bankare të personit të lidhur të subjektit me përshkrimin përkatës – Komisioni duhet të kishte konstatuar se faktet që do të provonte kontrata e marrëdhënies së punës, e cila ka përfunduar një dekadë përpara hetimit administrativ, ishin provuar përtej çdo kontestimi të arsyeshëm. Më së fundi, edhe fakti që bashkëshortja e subjektit ka punuar për këtë shoqatë për harkun kohor 1998-2010, në një specialitet që kryente shërbimet që ajo ofron për shkak të formimit të saj profesional, dhe ka ofruar të njëjtën natyrë pune/shërbimi, sikurse vërtetohet edhe nga librezat e punës, janë faktorë që duhet të kishin pasur peshë në analizën e Komisionit.

15.7. Ajo që është më e rëndësishme, analiza e Komisionit është tejet kontradiktore, pasi ndërsa sipas paragrafi 79.b të vendimit konkludon se nuk është provuar marrëdhënia e punësimit dhe ligjshmëria e të ardhurave, vetë paragrafi 79 shprehet se janë pranuar të ardhurat sipas shkresës së Arkivit të ISSh-së të reduktuara me pjesën takuese të sigurimeve dhe tatimeve. *Si konkluzion*, mospërfshirja e pagës së dhjetorit 2010, me arsyetimin se nuk është deklaruar në të ardhurat e përfituara në vitin 2011, është e pakuptimtë. Praktika e derdhjes në llogarinë bankare të pagës së dhjetorit në janarin e vitit në vijim, përdoret gjerësisht edhe për punonjësit që paguhet nga

²² Emri i shoqatës herë pasqyrohet “{***}”, herë “{***}”, por i referohet të njëjtës shoqatë.

²³ Kodi i Punës, neni 21përcakton që: “[2.] Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës. [...]”.

²⁴ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

4. Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur, sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit.

buxheti i shtetit, përfshirë edhe ata të institucioneve të rivlerësimit. Përjashtimi i kësaj të ardhure nga analiza e Komisionit mund të kishte kuptim nëse do të ishte bazuar hipotetikisht në faktin që pagesa ishte kryer shumë kohë pas pagesës së apartamentit ose për shkak të analizës së Komisionit për të pranuar të ardhurat e reduktuara nga punësimi në “{***}”, por gjithsesi jo për arsyetimin e shprehur në vendim. Trupi gjykues i Kolegjit çmoi t’i sjellë në vëmendje këto mospërputhje të vendimit të Komisionit, pasi kanë rëndësi për të qartësuar arsyet për zgjidhjen e ndryshme të çështjes.

15.8. Në përmbledhje, në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, është i pabazuar konstatimi i Komisionit në paragrafin 79/b të vendimit se subjekti nuk provoi marrëdhënien kontraktuale apo kushtet e punës/pagesës së bashkëshortes, për periudhën 2009-2010. Aktet e depozituara nga subjekti, përfshirë konfermat bankare të kalimit të pagës për këtë periudhë, librezat e punës, hapur në emër të bashkëshortes së subjektit nga ky punëdhënës që nga viti 1999 dhe shkresat nga institucionet zyrtare të ardhura në përgjigje të hetimit të kryer nga Komisioni, konfirmojnë pretendimin e subjektit për marrëdhënien e punësimit dhe kënaqin kërkesat e pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, sa i takon paraqitjes së dokumentacionit që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

15.9. Në vijim të arsyetimit më sipër, në kontekstin e ligjshmërinë së të ardhurave për punësimin e bashkëshortes së subjektit, qoftë në këtë hark kohor [për pasurinë objekt analize] apo edhe për punësimin e mëparshëm, trupi gjykues e gjen bindës e të bazuar pretendimin e subjektit se bashkëshortja ishte në kushtet e mirëbesimit. Paga ka kaluar nëpërmjet bankës dhe nuk kishte dyshime për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga punëdhënësi. Nga aktet evidentohet se ka mospërputhje të pagës së bashkëshortes së subjektit të derdhur në llogarinë bankare, me pagën mbi të cilën janë derdhur kontributet. Paga e derdhur në llogarinë bankare është më e lartë.

15.10. Subjekti është shprehur se ndryshimi i vlerave ka për bazë shpërblime apo bonuse të cilat i janë paguar bashkëshortes. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se referuar germës “a”²⁵ të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998 edhe shpërblimet *e tjera* në lidhje me marrëdhëniet e punës i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale. Për më tepër, siç evidentohet nga statement i llogarisë bankare të personit të lidhur, këto vlera kanë kaluar me përshkrimin “kalim page”, pra, ishin të ardhura nga paga dhe jo bonuse e shpërblime, sikurse shpjegoi subjekti. *Së dyti*, sikurse arsyetuar më sipër, në kushtet që shlyerja e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi ishte detyrim i punëdhënësit, vlerat e dërguara nga punëdhënësi nëpërmjet bankës prezumohen se i janë nënshtuar fillimisht deduktiveve për efekt të detyrimeve tatimore e veprimit të punëdhënësit si agjent tatimor. Ashtu sikurse u evidentua në analizën e pasurisë nr.1 më lart, dhe në linjë me jurisprudencën e Kolegjit në disa raste në të cilat ngriheshin pyetje të ngjashme²⁶, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të besueshëm e bindës pretendimin e subjektit. Në analizën e kryer në Kolegj, u përfshinë të ardhurat e dokumentuara, sipas akteve për efekt të punësimit të bashkëshortes së subjektit, përfshirë edhe të ardhurat e dhjetorit 2010, lëvruar në janar 2011²⁷.

²⁵ 1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

²⁶ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 15/2021, paragrafi 21.23 – 21.26; (JR) nr. 6/2022; (JR) nr. 4/2023, paragrafi 48; (JR) 14/2023 dhe (JR) nr. 35/2022.

²⁷ Paga e dhjetorit rezulton në vlerën 650 euro ose 90.285 lekë, kaluar në llogarinë bankare të pagës së bashkëshortes së subjektit më 06.01.2011.

15.11. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se, për sa kohë është provuar ekzistenca e marrëdhënies së punës dhe mirëbësimi i bashkëshortes për prezumimin ligjor, që gjen zbatim në shlyerjen e detyrimit që i përkasin punëdhënësit, pretendimi i subjektit është i bazuar. Për rrjedhojë, në vlerësimin e kryer nga Kolegji, të ardhurat e përfituara nga paga e bashkëshortes kalojnë testin e ligjshmërisë, parashikuar nga pika 3, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 19, e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për t'u pranuar si burim i ligjshëm i krijimit të pasurisë apartament në Orikum, Vlorë.

C.II.2. Për deklarimet në deklaratat periodike të viteve 2005 dhe 2007

15.12. Gjatë hetimit administrativ, nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja, Komisioni ka konstatuar korrigjime në deklarimin e shtesës së gjendjes *cash* në dy nga deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në atë për vitin 2005 dhe për vitin 2007. Komisioni nuk i ka pranuar shpjegimet e subjektit se korrigjimet janë kryer në momentin që ai i dispononte deklaratat, përpara dorëzimit, në kushtet që deklaratat në atë kohë plotësoheshin mekanikisht me shkrim dore. Vlerat e deklaruara në këto deklarata, Komisioni nuk i bëri pjesë të analizës financiare të mundësisë së subjektit në funksion të krijimit të pasurisë objekt analize. Sipas Komisionit, këto korrigjime konsiderohen si pasaktësi në deklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen *cash* dhe çojnë në përfundimin se në këtë rast deklarimi i subjektit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

15.13. Subjekti kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke parashtruar të njëjtat shpjegime për mënyrën sesi plotësoheshin deklarata periodike në vitet në fjalë [me shkrim dore] dhe që në kushtet që subjektet deklaruuese pajiseshin vetëm me një kopje fizike të formularit të deklarimit nga ILDKPKI-ja, nuk ka disponuar kopje rezervë për të reflektuar korrigjimin. Po ashtu, subjekti, edhe në ankim, thekson se korrigjimet janë kryer para dorëzimit të formularëve pranë ILDKPKI-së dhe janë pranuar nga ky institucion.

15.14. Trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, vëren se kualifikimi ligjor i konkluduar nga Komisioni për pamjaftueshmëri në deklarime me pasojë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si shkak për shkarkimin nga detyra, është i pabazuar në ligj. *Së pari*, deklarimi i pamjaftueshëm, për efekt të procesit të rivlerësimit, lidhet me deklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe jo në deklaratat periodike. Në kushtet që deklarimet periodike vjetore janë parashikuar, normohen dhe përgjegjësia për saktësinë e tyre gjen pasqyrim në ligjin përkatës, atë nr. 9049/2003, zbatimi i një mase, sikurse deklarimi i pamjaftueshëm, sipas ligjit nr. 84/2016, që normon procesin e rivlerësimit kalimtar dhe saktësinë e deklarimeve për efekt të kontrollit që kryhet në këtë proces, është një konkluzion i pabazuar në ligj.

15.15. *Së dyti*, në rrethanat konkrete faktike, në kushtet që deklarimet e subjektit janë pranuar nga ILDKPKI-ja me korrigjimet në fjalë²⁸ dhe në dosje nuk gjendet ndonjë procesverbal, evidencë apo vërejtje mbi administrimin e formularëve të deklaratave periodike të vitit 2005 dhe 2007 nga institucioni përkatës, nuk mund të argumentohen arsye objektive për të mos i pranuar ato si

²⁸ Neni 27 i ligjit nr. 9049/2003, parashikon edhe mundësinë e korrigjimit të gabimeve në deklarim, nëse ILDKPKI-ja konstaton të tilla: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë ose ai i ulet thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim”.

dokumenti zyrtar autentik. Nuk rezulton edhe që ILDKPKI-ja të ketë konstatuar ndonjë problematikë, përfshirë edhe sa rezulton nga procesverbali i mbajtur në fillim të vitit 2016, në këtë institucion, lidhur me deklaratat periodike apo me korrigjimet në fjalë. Në rastin konkret, pas thirrjes nga ILDKPKI-ja, subjekti është paraqitur në shkurt të vitit 2016 dhe ka dhënë shpjegime me shkrim. Në këtë procesverbal nuk evidentohen pyetje apo kërkesa për sqarime të korrigjimeve të deklaratave të vitit 2005 dhe 2007.

15.16. Në konfirmim të qëndrimeve të tij të mëparshme, Kolegji çmon të theksojë rëndësinë e deklaratave periodike në drejtim të verifikimit të plotësisë e saktësisë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Pa përsëritur jurisprudencën e Kolegjit, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016²⁹, për gjendjet *cash* deklarimi periodik është ndër mënyrat efektive të dokumentimit dhe të provueshmërisë së ekzistencës së tyre në kohën e krijimit³⁰. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj për vitet 2005 dhe 2007, rezulton që subjekti kishte mundësi të kursente *cash*-in e deklaruar me burime të ligjshme. Ajo që është me rëndësi, konkluzioni i Komisionit është kontradiktor edhe pasi ndonëse nga njëra anë Komisioni vlerëson se ka deklarim të pamjaftueshëm, nga ana tjetër, këto vlera rezulton t'i ketë përfshirë në analizë.

15.17. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit për pasaktësi në deklaratat periodike vjetore në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet që edhe Komisioni ka konkluduar se subjekti ka burime të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet në fjalë, edhe në Kolegj ato u përfshinë në mesin e të ardhurave të disponuara për efekt të krijimit të pasurisë objekt analize. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në konsideratë vlerat e deklaruara të kursimeve *cash* në analizën e kryer për verifikimin e kursimeve të akumuluar ndër vite, konstaton se subjekti gjendet në kushtet e mundësisë së krijimit të pasurisë objekt analize. Nga ana tjetër, balanca negative e burimeve të ligjshme e fundvitit 2011, për të krijuar kursime e përballur shpenzime, rezultoi në një vlerë të papërfillshme.

C.III. Lidhur me automjetin tip “Ford Focus/C Max”

16. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* blerjen e kësaj pasurie, me kontratën e datës 10.12.2012, me çmimin 14.900 euro dhe burime: të ardhura familjare të krijuara pas datës 01.10.2011 dhe gjatë vitit 2012, shumën 1.000 euro nga shitja e një automjeti tjetër, dhuratë në shumën 4.000 USD nga vjehri, si edhe një hua pa interes në shumën 5.000 euro, marrë nga një i afërm (shlyer në vitin 2013-2014). Subjekti ka provuar shlyerjen e detyrimit nëpërmjet një mandatpagese bankare të datës 11.12.2012, në llogari të shitësit [{"***"} ShPK]. Në deklaratën periodike për vitin 2012, subjekti ka deklaruar dhurimin nga vjehri dhe huan. Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti ka deklaruar për herë të parë edhe marrjen e një huaje tjetër prej 5.000 eurosh, nga një individ i dytë [z. E. V.] në datën 11.12.2012, për kryerjen e pagesës për automjetin objekt analize. Kjo shumë e fundit, sipas subjektit, është shlyer nga fonde të tërhequra nga llogaritë bankare midis datave 18.12 -- 26.12.2012, në vlerë totale 730.000 lekë.

16.1. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.748.372 lekë, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, shtesën në likuiditete bankare dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara gjatë vitit 2012, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe

²⁹ 5. Deklarimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.

³⁰ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, pg. 25.7.

neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Ndhima/huaja nga huadhënësi i deklaruar prej tij për herë të parë në hetimin administrativ, si burim për blerjen e automjetit, referuar jurisprudencës së Kolegjit³¹, u vlerësua si përpjekje për të deformuar burimet e krijimit të pasurisë. Për këtë konstatim të fundit, Komisioni shprehet se subjekti është ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 dhe nenit 33, pika 5, germa “a” të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, Komisioni nuk ka pranuar as shpjegimet e subjektit mbi mbulimin e shpenzimeve të një udhëtimi në Korfuz, Greqi, nga huadhënësi/z. E. V., duke ia ngarkuar shpenzimet e këtij udhëtimi subjektit.

16.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion në tërësi, me argumentet e përmbledhura në hyrje të vendimit. Kryesisht, prapësimet e tij fokusohen në saktësinë e deklarimit të burimeve si kursime të gjithë vitit, deklarimin e huas si burim me saktësi e detaje [shlyerjen në vitet në vijim], në kundërshtimin e analizës përtej kufijve të huas për këtë person tjetër të lidhur, në kundërshtim me orientimet e Kolegjit, dhe që pamjaftueshmëria e burimeve të huadhënësit i është bërë e njohur vetëm me vendimin. Subjekti kërkon përfshirjen e vlerës 164.331 lekë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara për krijimin e pasurisë, pasi i ka pasur gjendje në banesë në fund të vitit 2011. Po ashtu, subjekti argumenton se huaja e marrë për disa ditë nga një mik tjetër ishte për nevoja të ngutshme, pasi fondet në bankë në ditën e blerjes së automjetit, gjendeshin në depozitë me afat, prishja e të cilës shoqërohet me veprime administrative shtesë dhe kosto financiare. Huaja nga miku i i tij, z. E. V., që kishte *cash* në banesë, ishte opsioni më i lehtë³². Së fundmi, subjekti kundërshton analizën e Komisionit për shpenzimet e një udhëtimi familjar në Korfuz, deklaruar të mbuluara nga i njëjti huadhënës, po ashtu deklaruar si mik i tij. Konkluzioni i Komisionit, referuar më sipër, ka për bazë kryesisht analizën e kursimeve të vitit 2011 dhe dy huat e marra nga subjekti.

16.3. Nga analiza tërësore e gjithë aspekteve të krijimit të kësaj pasurie, sipas akteve në fashikull dhe pas shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë për burimet e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht nga kjo pasaktësi, në kushtet që subjekti dhe personat e tjerë të lidhur të identifikuar si huadhënës, nuk rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme, trupi gjykues e vlerëson me peshë jo përcaktuese këtë konstatim. Në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë, trupi gjykues vlerësoi se janë të pranueshme e bindëse shpjegimet e subjektit për kontributin e të njëjtit individ kundrejt një udhëtimi disaditor jashtë shtetit në vitin 2012, duke mbajtur në konsideratë aktet në fashikull, përfshirë shpjegimet e subjektit në 2016 në ILDKPKI apo aktet që tregojnë një ndërveprim të drejtpërdrejtë të këtij personi tjetër të lidhur në mundësimin e udhëtimit për subjektin apo burimet e ligjshme të mjaftueshme në disponim të tij. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

16.4. Një ndër aspektet relevante në konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri lidhet me një hua të cilën subjekti e deklaroi gjatë pyetësorëve. Konkretisht, pasi Komisioni i kërkoi informacion për tërheqjen e një shume në *cash* nga llogaritë bankare në dhjetor 2012, subjekti u shpreh se tërheqja kishte për qëllim të shlyente një hua të marrë prej tij nga një mik i tij, z. E. V., në dhjetor 2012 dhe solli një deklaratë noteriale të huadhënësit për të provuar këtë fakt³³. Subjekti shpjegoi,

³¹ Komisioni ka referuar çështjen nr. 11/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Bajrami, <https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendimi-Artan-Bajrami-i-anonimizuar-per-web.pdf>.

³² Për të provuar këtë subjekti citon mandatin e një tërheqjeje bankare të kryer nga E. V., në datën 04.12.2012.

³³ Subjekti citon dhe Komisioni e pranon administrimin e deklaratës me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.01.2021.

ndër të tjera, se në fund të dhjetorit të vitit 2012 ka tërhequr nga llogaria e tij dhe e bashkëshortes vlerën 730.000 lekë, për t'i kthyer shumën 5.000 euro z. V., të cilën e kishte kërkuar, pasi u ndodh në situatë të ngutshme për kryerjen e pagesës së automjetit. Sipas subjektit, huaja ishte e përkohshme, pasi kompania shitëse kërkoj që pagesa të kryhej e plotë përpara se të dorëzohej automjeti në datën 11.12.2011 dhe ai e bashkëshortja e kishin të pamundur të kryenin tërheqje aq të ngutshme në bankë.

16.5. Komisioni i ka vlerësuar shpjegimet e mësipërme si përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën dhe situatën e mungesës së burimeve të ligjshme të kësaj pasurie. Në përfundim, huaja në fjalë nuk u përfshi në mesin e burimeve të ligjshme meqenëse nuk kishte gjetur pasqyrim në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike. Shuma e tërhequr në dhjetor 2012, në totalin prej 730.000 lekësh, u pasqyrua si shpenzim.

16.6. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, vlerësoi të mos e përfshijë shumën e marrë hua në mesin e burimeve të disponuara në funksion të krijimit të pasurisë objekt analize, në kushtet që huaja e pretenduar nuk është pasqyruar qoftë në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në akte të tjera të kohës, pavarësisht nga disa indicie që lidhen me transaksionet bankare të tërheqjeve, të cilat përkojnë në kohë me marrëdhënien e huas. Nga dokumentacioni i dorëzuar prej subjektit [statement bankar i E. V. në BKT], huadhënësi ka tërhequr vlerën 1.600.000 lekë në datën 04.12.2012. Kjo datë përkon në kohë përpara blerjes së automjetit, më 11.12.2012. Duke pasur në konsideratë kohën relativisht të shkurtër brenda këtyre dy momenteve –18 ditë e përpara afatit kohor të vendosur nga ligji nr. 9049/2003, si cak brenda të cilit ligji kryhet deklarimi periodik vjetor – apo edhe që tërheqja e likuiditeteve nga llogaritë bankare përkon në kohë me momentin e marrjes së huas, shpjegimet e subjektit tregojnë për deklarim të pasaktë të burimeve të krijimit të pasurisë. Në kushtet që subjekti e bashkëshortja kanë tërhequr fondet nga llogaritë bankare pas kësaj date, përkatësisht më 18, 20, 24 dhe 26 dhjetor 2012, deklarimi i saktë i subjektit do të përfshinte si burim huan e shlyer me likuiditetet e tërhequra në vijim dhe jo kursimet e vitit. Për rrjedhojë, edhe në vlerësimin e Kolegjit, mosdeklarimi i kësaj huaje në deklaratën e pasurisë *vetting* e bën deklarimin e subjektit të pasaktë, sipas germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Konkluzioni i Komisionit për këtë aspekt është i bazuar.

16.7. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit nuk e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit se subjekti është përpjekur të deformojë të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave që do ta shpëtonin nga situata e justifikimit të burimeve. Jo vetëm sepse huamarrja është deklaruar përpara se subjekti të përballej me rezultate negative financiare, por sepse ai nuk rezulton të ketë pasur arsye të ketë pasur pritshmëri për balancë negative burimesh të ligjshme të huadhënësit, në kushtet që shkresa e Drejtorisë së Tatimeve për xhiron e vitit 2012 të z. Veliaj në shumën prej rreth 9.000.000 lekësh, tregon të kundërtën e nevojës për të deformuar faktet apo situatën e mungesës së burimeve të ligjshme.

16.8. Për sa më lart, në analizën e kryer në Kolegji, u mbajt në konsideratë deklarimi i subjektit për krijimin e pasurisë me të ardhurat familjare të krijuara pas datës 01.10.2011 dhe gjatë gjithë vitit 2012, duke përjashtuar huan e marrë nga z. V.. Nga ana tjetër, vlera 730.000 lekë e tërhequr nga subjekti dhe bashkëshortja në fund të vitit 2012, u përlllogarit në funksion të shlyerjes së huas së marrë z. V. dhe jo si burim i krijimit të pasurisë automjet “Ford Focus”. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se e gjeti të bazuar pretendimin e subjektit për moskonsiderimin e kësaj shume [730.000 lekë] si shpenzim të periudhës 18.12.2012-31.12.2012. Në kontekstin e kontabilitetit, analiza financiare bazohet në konceptin e flukseve monetare hyrëse dhe dalëse.

Në këtë mënyrë, shtesat në llogarinë bankare kanë të njëjtin kah me shpenzimet, ndërkohë që pakësimet/tërheqjet nga llogaritë bankare kanë të njëjtin kah me të ardhurat, pasi janë fonde në dispozicion të subjektit për të përballuar teorikisht investime/shpenzime të caktuara. Vendosja e kësaj vlere të tërhequr si *shpenzim*, sikurse ka vepruar Komisioni, rëndon situatën e subjektit, pasi këto fonde mund të jenë përdorur për shpenzime të tjera, të përfshira tashmë në analizën vjetore. Në këtë linjë, në kushtet që pretendimi i subjektit mbi përdorimin e kësaj shume si burim për krijimin e pasurisë objekt analize nuk u pranua, cilësimi i tërheqjeve si shpenzim ekstra është *paragykues*. Së fundmi, kjo logjikë nuk është ndjekur për tërheqjet e tjera e, si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet objektivisht e bazuar vetëm për këto tërheqje.

16.9. Duke iu rikthyer kontributit të këtij huadhënësi, një aspekt tjetër shkak ankimi është një udhëtim njëjavor familjar i subjektit në Korfuz, që, sipas tij, e ka financuar z. E. V.. Komisioni e ka gjetur jobindës shpjegimin e subjektit, meqenëse ishte vetëm familja e tij dhe përbën një dhuratë dhe trajtim preferencial, që nuk është deklaruar në vitin 2012, sipas ligjit nr. 9049/2003. Komisioni ka theksuar detyrimin e subjektit për deklarimin e kësaj marrëdhënieje pranë ILDKPKI-së si një trajtim preferencial, për t'iu mundësuar organeve kompetente edhe kontrollin e konfliktit të interesit, në kushtet kur z. V. së bashku me bashkëshorten ushtronin profesionin e avokatit. Komisioni, po ashtu, ka vlerësuar se aktet e sjella nga subjekti nuk provojnë pronësinë e likuiditeteve për kryerjen e pagesës së udhëtimit, por vetëm komunikimet e kryera për organizimin e udhëtimit. Për rrjedhojë, Komisioni ka vendosur që një shpenzim prej 1.299 eurosh të vitit 2012, për këtë udhëtim, t'ia ngarkojë subjektit.

16.10. Subjekti kundërshton këtë konkluzion, duke potencuar aktet e sjella prej tij dhe shpjegimet e dhëna në shkurt 2016 në ILDKPKI. Po ashtu, subjekti shprehet se nuk ka pasur detyrim deklarimi për trajtim preferencial, pasi marrëdhënia e tij me dhuruesin është marrëdhënie miqësore, e palidhur me punën dhe pa asnjë konflikt interesi apo trajtim preferencial. Z. V. dhe bashkëshortja e tij ushtrojnë profesionin e tyre në fushën e të drejtës civile e, për pasojë, ai nuk ka pasur asnjë konflikt interesi. Përfundimi i Komisionit është i palogjikshëm e bie ndesh edhe me konkluzionin, pasi nëse pagesa do të ishte bërë prej tij, sikurse e ka përlllogaritur Komisioni, nuk ka vend për të konstatuar për “dhuratë dhe trajtim preferencial”. Në kushtet kur në qershor dispononte likuiditete, është e palogjikshme nevoja e tij për të krijuar një skemë të tillë për të justifikuar shpenzimin.

16.11. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka depozituar edhe një deklaratë të hartuar gjatë hetimit administrativ, të këtij individi, që konfirmon pretendimet e subjektit³⁴. Subjekti kërkon nga Kolegji që kjo deklaratë të trajtohet si dokument shkresor, në kuptim të germës “c” të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, në pajtueshmëri me provat e tjera. Subjekti ka përcjellë edhe kopje të noterizuar të komunikimeve elektronike që individi në fjalë ka pasur me agjencinë turistike. Në fashikull gjendet edhe procesverbali datë 16.02.2016 mbajtur në ILDKPKI, me shpjegimet e subjektit për këtë udhëtim, në të njëjtën linjë.

16.12. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpjegimet e subjektit dhe aktet e sjella prej tij në mbështetje të pretendimit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në qershor 2012, në Greqi, nga z. E. V., u gjetën të besueshme. Duke e konsideruar z. V., për efekt të këtij shpenzimi, si person tjetër i lidhur, për shkak të financimit të udhëtimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet

³⁴ Deklarata noteriale e z. E. V., datë 24.02.2021, sipas së cilit: “[...] në muajin qershor 2012, i kam organizuar familjes së shokut tim Genci Qana një udhëtim njëjavor në Korfuz, Greqi, që ka kushtuar 1.290 euro. Udhëtimi është organizuar me këmbënguljen time dhe me dëshirën për të kënaqur vajzat e tij [...]”.

në fashikull -- procesverbali i mbajtur në vitin 2016 në ILDKPKI dhe aktet nëpërmjet të cilave personi tjetër i lidhur ka hyrë në kontakt për të organizuar takimin, që është akt i kohës – nuk mund të argumentohet se janë jobindëse apo se nuk mbështesin shpjegimet e subjektit për rrethanat në të cilat u krye ky udhëtim³⁵.

16.13. Në kushtet që Komisioni nuk ka hetuar në drejtim të mundësisë së qenies së subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të detyrës me këtë person, konstatimi për trajtim preferencial ka mbetur i paplotë. Nga ana tjetër, Komisioni nuk i ka dhënë pasojë këtij konstatimi në masën disiplinore e, për rrjedhojë, mbetet pa peshë përcaktuese. Për gjithë sa më sipër, në analizën financiare të kryer nga Kolegji në kontroll të vendimit, shuma që përkon me udhëtimin nuk iu ngarkua subjektit të rivlerësimit.

16.14. Duke iu rikthyer burimeve të krijimit të pasurisë objekt analize në këtë rubrikë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se Komisioni i ka tejkalluar kufijtë e hetimit të personit tjetër të lidhur, të deklaruar, po ashtu, si huadhënës kundrejt krijimit të kësaj pasurie [z. Z. D.]. Konkretisht, në kushtet që në rrethanat konkrete nuk është në diskutim në asnjë formë apo për asnjë shkak fshehje pasurie e subjektit në emër të këtij personi, me hetimin përtej kufijve të marrëdhënies së huas me subjektin, pa asnjë arsyetim, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me orientimin e Kolegjit për kufijtë e kontrollit të pasurisë së personave të tjerë të lidhur, duke nisur nga vendimi (JR) nr. 15/2019. Po ashtu, duke qenë se u konfirmua mundësia e këtij personi tjetër të lidhur për të kontribuar me huan prej 5.000 eurosh, qëndrimi i Komisionit u vlerësua i pabazuar në ligj dhe pretendimi i subjektit i drejtë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

16.15. Nga aktet në fashikull, rezulton se përpos deklaramit të kësaj huaje në vitin 2012 dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka dorëzuar edhe një deklaratë noteriale të huadhënësit në datën 29.10.2016. Po ashtu, subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas në deklaratat periodike vjetore në vijim. Komisioni ka hetuar për mundësinë e financimit të huas me burime të ligjshme dhe ka konstatuar disa zëra për të cilët të ardhurat e pretenduara të këtij personi tjetër të lidhur nuk janë dokumentuar³⁶. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar se huadhënësi nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për të financuar huan, pa marrë në konsideratë edhe investimet e kryera. Në analizën e kryer në atë fazë procedurale, Komisioni nuk e ka përfshirë huan në fjalë. Në vendim, pasi Komisioni përfshiu në analizën e mundësisë së huadhënësit edhe investimet e kryera prej tij, ai rezultoi në kushtet e pamundësisë së dhënies së vlerës 5.000 euro.

16.16. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se përpos faktit që Komisioni ka shkuar përtej kufijve të hetimit të një personi tjetër të lidhur, qëndron pjesërisht pretendimi i subjektit për mungesë dijenie për kufijtë e shqyrtimit që Komisioni ka finalizuar vetëm në vendim, duke përfshirë edhe investimet e tjera të personit tjetër të lidhur. Ndonëse subjekti kishte dijeninë që do t'i duhet të përmbyste barrën e provës edhe me një analizë të thjeshtë, drejtimet dhe aspektet për të cilat ai u orientua nga rezultatet e hetimit rezultuan të ndryshme nga ato për të cilat konkludoi, përfundimisht, Komisioni në vendim, duke përfshirë gjithë investimet që i rezultuan të jenë kryer

³⁵ Referuar edhe xhiros vjetore të z. V., në një shumë prej përreth 9.000.000 lekësh, referuar administratës tatimore.

³⁶ Konkretisht, Komisioni shprehet për mungesë dokumentimi të vlerës së përfutuar nga qiratë, dhe detajet e përfitimeve e tatimin e paguar, por edhe shpenzimet për jetesë, “pa marrë në konsideratë edhe investime të kryera në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme gjatë kësaj periudhe”. Komisioni ka referuar edhe shpenzimet për blerjen e një automjeti nga ky person në datën 14.01.2012. Gjithashtu, Komisioni është shprehur në rezultatet e hetimit se nuk i merr në konsideratë të ardhurat e huadhënësit për shkak se nuk ka dokumentacion ligjor provues që ambienti i dhënë me qira i është dhënë atij ta përdorë apo ta marrë hua nga një i afërm.

prej tij, përfshirë një automjet dhe një apartament³⁷. Në këto kushte, dhe duke ritheksuar mungesën e plotë të çdo lloj argumentimi, për arsyet për të cilat këto investime u përfshinë në analizë në funksion të huas dhe përse në vendim e jo gjatë rezultateve të hetimit, trupi gjykues e gjen konkluzionin e Komisionit të pabazuar dhe të padrejtë, pasi në rrethanat konkrete, subjekti e ka pasur të pamundur të mbrohej e sillte akte, të cilat, më së paku, mund të provonin burime të tjera financiare të huadhënësit nëpërmjet të cilave janë mbuluar këto investime.

16.17. Për sa më sipër, edhe njëkohësisht duke ritheksuar jurisprudencën e Kolegjit duke nisur nga korriku i vitit 2019, me vendimin nr. 15/2019, ndër të tjerë, që paradaton vendimin e Komisionit, për kufijtë e analizës që do të kryhet për personat e tjerë të lidhur, në çështje të tjera, Kolegji korrektoi analizën e Komisionit në linjë me raste të ngjashme³⁸, duke u bazuar në të ardhurat dhe zbritur shpenzimet e jetesës. Kjo analizë, në zbatim të qëllimit të ligjit dhe në linjë me qëndrime të Kolegjit, përmbush kriteret e një vlerësimi të arsyeshëm e proporcional, lidhur me mundësitë e personave të tjerë të lidhur, duke krijuar një panoramë të mjaftueshme për marrjen e një vendimi, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të dhëna hua apo dhuruar sipas rastit. Nga kjo analizë, huadhënësi rezulton me mundësi për dhënien e huas në vlerën 5.000 euro në datën 10.12.2012. Për rrjedhojë, kjo vlerë u përfshi në analizën financiare për blerjen pasurisë shkak ankimi.

16.18. Në përfundim të vlerësimeve dhe pas analizës ligjore e korrektiveve sipas arsytimit më sipër, nga kontrolli i analizës financiare të burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti në funksion të krijimit të kësaj pasurie, subjekti rezultoi me një balancë negative prej (-) 709.687 lekësh, për krijimin e kursimeve dhe mbulimin e shpenzimeve. Nga ana tjetër, sipas këtyre korrektiveve, viti 2012 rezultoi me bilanc pozitiv.

C.IV. Për automjetin e personit të lidhur, tip “Fiat Punto”

17. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri në pronësi të bashkëshortes, blerë në vitin 2013, në vlerën 150.000 lekë, dhe burim të ardhura nga kursimet familjare. I njëjti deklaram rezulton edhe në deklaratën periodike të vitit 2013. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka dokumentuar burimet e të ardhurave në vlerën e plotë të automjetit, duke konstatuar një balancë negative prej (-) 213.628 lekësh. Përfundimisht, Komisioni, për këtë pasuri, shprehet se subjekti ka qenë inkohorent në deklarime dhe ka bërë përpjekje për të deformuar të vërtetën *në funksion të paraqitjes së të dhënave që do ta shpëtonin nga justifikimi i burimit të ligjshëm të pasurive*, duke konkluduar për deklaram të pamjaftueshëm, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61 dhe germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u bazua kryesisht në vlerësimin e Komisionit për një hua nga vjehri i subjektit, të marrë e të shlyer brenda vitit, e cila është deklaruar në përgjigje të rezultateve të hetimit.

17.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi i burimit të ardhura nga kursimet, në deklaratën *vetting*, është i saktë e në përputhje me ligjin. Burim i krijimit të pasurisë janë

³⁷ Referuar paragrafit 139 të vendimit dhe tabelës pjesë e tij.

³⁸ Vendimi i Kolegjit JR nr. 2/2023 që i përket subjektit të rivlerësimit Elona Toro; vendimi i Kolegjit (JR) nr. 20/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Osmani; vendimi i Kolegjit (JR) nr. 7, datë 24.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti, paragrafët 93 e 94; vendimi i Kolegjit (JR) nr. 20, datë 08.09.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi, paragrafët 21 – 21.4; vendimi i Kolegjit (JR) nr. 21, datë 10.09.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj, paragrafët 75 e 77; vendimi i Kolegjit (JR) nr. 4, datë 09.02.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beci, paragrafët 144 – 146.

kursimet nga të ardhurat e gjithë vitit 2013, me të cilat shleu vlerën 150.000 lekë të dhënë në formë ndihme nga prindërit e bashkëshortes, të cilën ua ka kthyer brenda vitit.

17.2. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të pretendimeve të subjektit në ankim dhe akteve në fashikull, konfirmon balancën negative të përlogaritur në Komision për krijimin e pasurisë dhe përbalimin e shpenzimeve. Për rrjedhojë, edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit u gjend në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimi e kësaj pasurie, sipas gurmës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, në kushtet që Komisioni ka kryer analizën financiare mbi bazën e burimeve të deklaruar në deklaratën *vetting*, deklarimi i pasaktë, sipas përcaktimit të gurmës “a” pika 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nuk vlerësohet se ka vend për zbatim. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

17.3. *Së pari*, nga aktet në fashikull rezulton se pasuria objekt analize është blerë më 02.02.2013 në vlerën 150.000 lekë, sipas kontratës noteriale. Komisioni ka përlogaritur një vlerë balance negative të krijimit të kësaj pasurie dhe shpenzimeve deri në atë datë³⁹. Komisioni nuk ka kryer një analizë financiare të vjehrrit të subjektit, pasi e ka konstatuar të panevojshme në kushtet që flitet për një burim të padeklaruar më parë.

17.4. Në të njëjtën linjë si Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit, e kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie bazuar në deklaratën periodike vjetore dhe atë *vetting*. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit se huaja është shlyer nga kursimet vjetore, me të njëjtin arsyetim si edhe huaja nga z. V. për krijimin e automjetit të analizuar më sipër, nuk u përfshi në analizën financiare të burimeve të disponuara nën dritën e detyrimit që ka pasur subjekti për të deklaruar burimet e krijimit në kohën kur pasuritë janë krijuar, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Nga analiza financiare e kryer mbi bazën e kësaj qasjeje, edhe në Kolegj u konfirmua pamundësia e krijimit të pasurisë në shumën 150.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruar dhe të evidentuara për periudhën në fjalë. Ndërkohë analiza financiare e të gjithë vitit 2013 rezulton me bilanc pozitiv.

C.V. Përdorimi i apartamentit të dhuruar nga vjehrrin në periudhën 2008 – 2011

18. Në deklaratën periodike të vitit 2012, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar apartament me sipërfaqe 115,97 m², në rrugën “{***}”, Tiranë dhe dy garazhe nëntokësorë të dhuruara pa kusht dhe pa shpërblim nga babai i saj, referuar kontratës së dhurimit datë 22.09.2012. Komisioni ka konstatuar se duke mosdeklaruar në deklaratat periodike për vitet 2008 – 2011, të drejtat mbi këtë pasuri/përdorimin, subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe ndodhet në kushtet e gurmës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

18.1. Subjekti potencon se deklaramet e tij dhe të bashkëshortes kanë qenë në përputhje me ligjin e kohës. Duke iu qëndruar shpjegimeve në Komision, edhe në ankim, subjekti pretendon se mosdeklarimi i përdorimit të apartamentit nga viti 2008-2012 ka ndodhur për faktin se deri në atë moment kjo pronë nuk ka qenë e regjistruar dhe *de jure* nuk kishte asnjë pronar. Meqenëse formularët e deklarimit kërkonin që të shënohej shtesa ose pakësimi i pasurisë, kjo pronë, duke mos qenë e regjistruar, nuk mund të shënohej në deklaratë.

18.2. Trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të pretendimeve të subjektit për këtë çështje, çmon të ritheksojë që objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit është saktësia dhe vërtetësia e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në rastin konkret, konkluzioni i Komisionit për

³⁹ Balanca negative e llogaritur përfshirë shpenzimet e periudhës rezulton në vlerën (-) 213.628 lekë.

pasaktësi, ndonëse i referohet ligjit nr. 84/2016, në thelb përbën vlerësim të saktësisë të deklaratave periodike vjetore, të cilat parashikohen e normohen nga ligji nr. 9049/2003. Në këto kushte, vlerësimi i Komisionit, bazuar në një kuadër ligjor, i cili është miratuar për shkak të procesit të rivlerësimit e ka hyrë në fuqi disa vite pasi subjekti duhet të kishte deklaruar përdorimin e apartamentit, është i pabazuar në ligj e nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

18.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se nga muaji nëntor i vitit 2008 ka nisur arredimin e apartamentit të dhuruar, i cili është bërë i banueshëm në muajin mars të vitit 2009. Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar edhe vendqëndrimin në këtë apartament. Më herët subjekti ka deklaruar banimin në pasurinë e parë analizuar më sipër.

18.4. Nga aktet konstatohet se vjehri i subjektit ka qenë pronar i një trualli⁴⁰ dhe shtëpie të trashëguar nga i ati e transkriptuar në vitet 1964 dhe 1965. Për këtë pasuri, ai ka lidhur një kontratë shkëmbimi në vitin 2004 me një firmë ndërtuese për të cilën përfitoi pesë apartamente, katër garazhe dhe një njësi shërbimi. Nga hetimi që ka kryer Komisioni ka rezultuar se vjehri i subjektit i ka dhuruar edhe fëmijëve të tjerë të tij. Certifikata e pronësisë së apartamenteve tregon se pasuria është regjistruar/individualizuar më datë 14.06.2012. Ndërsa, në emër të vjehrit të subjektit, pasuritë janë regjistruar më datë 26.07.2012. Në emër të bashkëshortes, sipas kontratës së dhurimit, pronësia ka kaluar më datë 24.09.2012.

18.5. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në pronësi në deklaratën *vetting*. Nga sa më sipër, rezulton edhe që mënyra e përfitimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur me subjektin nuk ka treguar asnjë shkak për të vënë në dyshim deklaratimet e tij apo legjitimitetin e pasurive. Për më tepër, edhe duke abstraguar nga nëse qëndron interpretimi i subjektit për momentin kur atij i lindi detyrimi për të deklaruar përdorimin e kësaj pasurie, në kushtet që jo vetëm kjo marrëdhënie është korrektuar me deklarimin e plotë në deklaratën për vitin 2012 dhe, mbi të gjitha, që në procesin e rivlerësimit objekt kontrolli është deklarata *vetting*, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. E thënë ndryshe, përpos faktit që pasaktësitë në deklaratat periodike nuk mund të shoqërohen me masë disiplinore në kuadër të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit thekson edhe që burimet dhe mënyra e krijimit të pasurisë kanë qenë përtej çdo kontestimi të mundshëm dhe personi i lidhur e ka deklaruar në vitin 2012, duke mbyllur në këtë mënyrë edhe detyrimin si subjekt deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003.

18.6. Në këto kushte, mbështetur në nenet 33 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe në linjë me sa ka arsyetuar gjerësisht Kolegji⁴¹, duke theksuar se deklaratimet e pasakta, për t'u ngritur në nivel shkarkimi nga detyra, duhet të lidhen më së paku me deklaratimet në deklaratën *vetting*, në rastin konkret, nuk mund të konkludohet në asnjë këndvështrim se subjekti gjendet në ndonjë prej situatave të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës apo të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, që të sjellë, për pasojë, shkarkimin e tij nga detyra nëpërmjet zbatimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, siç u kualifikua nga Komisioni. Për rrjedhojë, edhe ky konkluzion i Komisionit u gjet i pabazuar.

⁴⁰ Me sipërfaqe 750 m² të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

⁴¹ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) 28/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit F. Vjerdha, vendimin (JR) nr. 31/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit G. Brahimllari, vendimin (JR) nr. 37/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit S. Ngresi.

D. Analiza e pretendimeve që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

19. Një ndër shkaqet që i shërbyen Komisionit si bazë për të marrë vendimin e shkarkimit nga detyra ka qenë edhe kriteri i kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk e ka plotësuar në mënyrë të saktë e me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, për shkak të mosdeklarimit të ndryshimit të mbiemrit. Sipas Komisionit, referuar pikave 2 dhe 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka bërë deklarament të pasaktë e të pamjaftueshëm të figurës, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u bazua në faktin që subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e figurës që për një periudhë disamujore ai dhe familja kanë pasur një shkronjë të ndryshme në mbiemër e konkretisht nga “Qama” në “Qana”.

19.1. Subjekti potencon se ka kryer deklarament të saktë e të mjaftueshëm për kontrollin e figurës. Ndryshimi i mbiemrit për një periudhë prej 8 muajsh është bërë nga punonjësja e gjendjes civile. Nëse ndryshimi do t'i atribuohet atij, sikurse shprehet Komisioni, ai legjitimohej që të ndryshonte vetëm mbiemrin e tij dhe jo gjithë familjes. Në shpjegimet në Komision, subjekti e ka konsideruar ndryshimin e mbiemrit si gabim material të bërë nga punonjësja e zyrës së gjendjes civile. Sipas tij është *veprim i cili mund të jetë bërë nga pakujdesia apo nga paaftësia* për të dalluar diferencën midis numrit të harqeve në shkronjat “n” dhe “m”. Subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni për këtë korrigjim dhe se ai ka qëndruar në regjistra për një periudhë 8-mujore.

19.2. Në vlerësim të akteve në fashikull dhe shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Mosdeklarimi i një korrigjimi material të një germe të mbiemrit, që ka afektuar gjeneralitetet e gjithë familjes së origjinës e, për pasojë, edhe të vetë subjektit apo që ka gjetur zbatim vetëm për një periudhë disamujore në vitin 1997, provuar qartazi të ketë qenë pasojë e gabimeve materiale të shkrimit, të kryera nga punonjës të një institucioni publik [të Gjendjes Civile], ndërkohë që nuk pa pasur asnjë pasojë konkrete në identifikimin e subjektit të rivlerësimit gjatë gjithë asaj periudhe kohore, qoftë në marrëdhëniet profesionale apo edhe në jetën e tij private, nuk mund të argumentohet si shkak për shkarkimin e tij nga detyra. Mbi këtë linjë arsyetimi, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarament të saktë në deklaratën e kontrollit të figurës. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

19.3. Nga aktet në fashikuj konstatohet se DSIK-ja është shprehur se subjekti ka mbajtur të njëjtat gjeneralitete. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile⁴², në tërësi, nga gjithë aktet e përcjella Komisionit gjatë hetimit administrativ, me burim institucionet shtetërore të çdo niveli⁴³ dhe ato të pushtetit vendor⁴⁴, kanë konfirmuar se ndryshimi i një germe të mbiemrit ka ndodhur për të gjithë familjen e subjektit. Ky gabim është korrigjuar më 25.02.1997 dhe mbiemri, sikurse rezulton edhe nga certifikata familjare lëshuar më datë 09.05.2019, në vazhdimësi ka qenë ai me

⁴² Nr. {***} prot., datë 30.04.2019.

⁴³ Zyra e Gjendjes Civile Berat, për të dhëna nga regjistri themeltar i vitit 1974, konstatohet se mbiemri i familjes së subjektit është “Qana”. Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr. {***} prot., datë 27.01.2021 drejtuar i ka dërguar Komisionit kopje të regjistrit themeltar të shtetasve, nga ku konstatohet se fleta e regjistrit me emrat e gjithë familjes së subjektit është e korrigjuar. Korrigjimi konsiston tek një germë e mbiemrit, e konkretisht nga Qama, në Qana. Shkresa referon se “më datë 25.02.1997, për të gjithë anëtarët e familjes “Qana”, janë kryer veprime për korrigjimin si gabim material në [...] rubrikën e mbiemrit nga “Qama” në “Qana”. Për [...] shtetasin Genci Qana, konstatohet se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.”

⁴⁴ Me shkresën e Njesisë Administrative Nr. 1, Bashkia Tiranë.

të cilin subjekti deklarohet e identifikohet⁴⁵. Në certifikatën e datës 25.02.2021, është bërë shënimi: *Korrigjuar mbiemrin familjarisht nga Qama në Qana, akti nr. {***}, datë 05.02.1997*. Në dosje është administruar edhe letërnjoftimi i datës 12.07.1982, lëshuar në bazë të regjistrimit themeltar të shtetasve, në të cilën mbiemri i subjektit është “Qana”. Edhe akti i emërimit të tij në detyrë i vitit 1995 dhe vitit 2000 është me mbiemër “Qana”. *Së fundmi*, edhe vërtetimi i Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁶ ka konfirmuar se në të gjitha funksionet që ka mbajtur subjekti, duke filluar nga 01.12.1988 e në vijim, në Elbasan apo në Tiranë, në çdo akt të lëshuar prej tij, në kapacitetin e tij zyrtar në Institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, është identifikuar me mbiemrin Qana.

19.4. Në referim të legjislacionit të kohës, ndryshimi i gjeneraliteteve bëhej me kërkesë drejtuar Këshillit të Komunës apo Bashkisë⁴⁷, duke treguar shkaqet e ndërrimit. Në dokumentin e përcjellë nga zyra e gjendjes civile nuk është paraqitur kërkesa apo vendimi i organit kompetent që vendosi ndryshimin, në mënyrë që të mund të evidentohet arsyeja përse mbiemri familjar ka pësuar ndryshimin e një germe. Në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile [nr. {***} prot., datë 27.01.2021], Komisionit i është bërë me dije se është kryer veprim për korrigjim si gabim material, dhe se subjekti *nuk ka kryer* ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Nëpërmjet kësaj përgjigjeje, deduktohet se gabimi material mund të jetë kryer vetëm nga punonjësit e gjendjes civile, kur është bërë transferimi i gjendjes civile, si dhe është korrigjuar nga zyra e gjendjes civile.

19.5. Po ashtu, konstatohet se Komisioni nuk ka kryer hetim nëse në këtë periudhë 8-mujore subjekti të ketë përdorur mbiemrin Qama për të udhëtuar jashtë shtetit apo për ndonjë aktivitet që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit për përdorim të një mbiemri tjetër nga subjekti, që për pasojë passjell deklarimin e tij për këtë fakt, është i pambështetur në akte. Për rrjedhojë, dhe në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë e të plotë në deklaratën për kontrollin e figurës. Në kushtet që ky ishte i vetmi aspekt i kontrollit të figurës, për të cilin Komisioni ka konstatuar papërshtatshmërinë, trupi gjykues i Kolegjit, duke e ndryshuar vlerësimin, e gjen subjektin të besueshëm edhe për këtë kriter.

20. Në përmbledhje të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm edhe në kontrollin e kriterit të pasurisë dhe atë të figurës, përpos atij profesional, konfirmuar edhe nga Komisioni. Balancat negative që u konstatuan në analizën e kryer në Kolegj për krijimin e pasurive, në vlerën (-) 1.202.928 lekë apo pasaktësitë në deklarimin e burimeve të krijimit, të evidentuara më sipër, janë të një peshe, e cila, nën dritën e parimit të proporcionalitetit, vlerësohet e pamjaftueshme për të passjellë shkarkimin e subjektit nga detyra. Për rrjedhojë, vendimi nr. 362, datë 31.03.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjendet i pabazuar dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴⁵ Nr. {***} prot., datë 26.02.2021.

⁴⁶ Nr. {***} prot., datë 22.02.2021.

⁴⁷ “Çdo shtetas ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e emrit ose të mbiemrit. Kërkesa i paraqitet këshillit të komunës ose të bashkisë, duke i treguar edhe shkaqet për ndërrimin e emrit ose të mbiemrit, si dhe emrin ose mbiemrin që ka zgjedhur.”

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 362, datë 31.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genci Qana.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 01.10.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi